

FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / KOSOVO / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA

*Kellemes karácsonyt és boldog új évet!
Srećni novogodišnji i božićni praznici!
Blagoslovljen božić i sretnu novu godinu!
Vesel božić in srečno novo leto!
Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri!*



E di që rreshtat që shkruaj në këtë faqe lexohen nga shumë njerëz. Shumë njerëz nga kultura të ndryshme, të cilët e festojnë vitin e ri në mënyra të ndryshme, ndoshta edhe në kohë tjetër. Në Shtetet e Bashkuara Holiday Season, "Festat" fillojnë në fund të nëntorit me Dhënien e Falenderimeve dhe zgjat deri në fillim të vitit të ri. Kjo është një periudhë e mrekullueshme e vitit, mbledhet së bashku familja dhe miqtë, atmosfera është plot me dashuri, të gjithë janë të shqetësuar për blerjet e krishtlindjeve dhe rrugët ndriçojnë nga dritat. Këtu, në Scottsdale zyra jonë çdo vit kalon në qendër të vëmendjes, pasi ndërtesën e veshim me më shumë se një milion llampa, kështu që në krishtlindje është tepër e bukur! Festat i presim gjithmonë me padurim. Kur përgatitemi për të përshëndetur një vit të ri, zakonisht kthehemi nga njëri-tjetri dhe bëjmë një pasqyrë të periudhës së kaluar, nxjerrim përfundimet dhe mësimet që i zbatojmë në të tashmen dhe kështu planifikojmë të ardhmen.



Joe Mangione

Të planifikojmë të ardhmen!

Është tepër joshëse që të tashmen ta jetosh duke qenë i sigurt se çdo veprimi ynë merr si përgjigje shpërblim të menjëhershëm. Por nëse përqendrohemi vetëm tek e tashmja, herët a vonë çdo shpërblim do të jetë një pasojë e padyshimtë. Sa më e thjeshtë është një veprimtari, aq më i natyreshëm do të jetë shpërblimi që i takon asaj. Dhe kjo është diçka e mirë, sepse forcat tona fizike dhe shpirtërore mund t'ia kushtojmë zhvillimit të fushave të tjera. Shembull i shkëlqyer është frymëmarrja. Nëse do duhej të përqëndroheshim në çdo marrje fryme, s'do na mbetej kapacitet për gjëra të tjera, sepse gjithë energjinë tonë do ta konsumonte përqëndrimi i vazhdueshëm. Ose të shohim procesin e ecjes. Kjo formë lëvizjeje si rezultat i një procesi mësimi është e natyrshe. Por për shkak të një sëmundje apo aksidenti këto veprimtari nuk janë më të natyrshe, dhe atëherë e kuptojmë se sa shumë varem nga ato. Mendoj se edhe shëndeti ynë është një lloj diçka e natyrshe, sidomos kur përqendrohemi vetëm tek e tashmja. I lemë thjeshtë jashtë vëmendjes pasojat e largëta të ushqimit jo të duhur dhe marrjes së pamjaftueshme të lëndëve ushqyese.

Është e qartë lidhja ndërmjet të mësipërmeve dhe biznesit Forever. Në fillim me një qëndrim tepër aktiv dhe të vetëdijshëm kemi dëshirë të madhe që të mësojmë sa më shumë, të marrim pjesë në aktivitete dhe t'ia ofrojmë mundësinë të gjithëve. E konsiderojmë si një sfidë të vazhdueshme që të bëhemi pjesë e asaj që ofron Forever. Me kalimin e kohës të mirat shëndetësore dhe materiale bëhen pjesë e jetës sonë, dhe — si është natyra e njeriut — ato bëhet të natyrshe. Vjen koha kur bëjmë më shumë para se sa kemi ëndërruar ndonjëherë, shëndeti ynë bëhet më i mirë se sa shpresonim më parë. Dhe mund të ndodhë lehtë që të fillojmë t'u kushtojmë më pak kohë veprimtarive nëpërmjet të cilave arritëm në pozitën e favorshme aktuale, e trajtojmë si diçka të natyrshe shëndetin dhe gjendjen tonë materiale për të cilat më parë punuam aq shumë.

Kam dëgjuar njëherë se 90% e veprimtarive tona janë rutinë e ardhur nga zakoni. I vetmi problem me këtë është se i kushtojmë më pak energji zhvillimit tonë. Pra meqë po vjen viti i ri, dhe vetëm disa ditë ndodhen prapa, të përgatisim inventarin vjetor, të shikojmë me radhë se çfarë na dha biznesi Forever, t'i riorganizojmë energjitë tonë sipas pikësnyimeve të reja! Të mos e konsiderojmë të natyrshe që edhe viti 2007 do të jetë i shkëlqyer vetëm sepse edhe viti 2006 ishte i tillë. Shpeshherë s'na vjen mirë, por të shikojmë në pasqyrë dhe ta vlerësojmë me singëritet vetveten. Gjërat nuk janë të

natyrshe! Nëse dëshironi të arrini më shumë se sa sipas të tjerëve është e mundshme, duhet të bëni më shumë se sa sipas të tjerëve është e arësyeshme.

Kam shumë besim tek e ardhmja, mezi e pres 2007-ën. Viti i kaluar ishte i shkëlqyer, kompania jonë u rrit dhe u zhvillua në shumë fusha. Kemi akoma nevojë për reagimin Tuaj. Sfidat jonë e përditshme është se asgjë nuk është e natyrshe. Sivjet edhe simboli ynë u rinovua, Shqiponja Forever është origjinale, madhështore dhe e fuqishme.

Edhe produktet tona nuk i konsiderojmë si të natyrshe. Përpiqemi për zhvillimin e vazhdueshëm të përbërjes së tyre, ndërkohë që krijojmë produkte të reja. I modernizuar shumë pajisjet e fabrikës Aloe Vera of America. E rritëm aq shumë prodhueshmërinë tonë, sa që sot jemi në gjendje të prodhojmë me miliona bidona me pije aloe dhe produkte të tjera në muaj dhe t'i shërbejmë në mënyrë të vazhdueshme kërkesat gjithmonë e në rritje. Modernizuar sistemin e kontrollit të cilësisë, si dhe sistemin operativ të logjistikës që funksionon në gjithë botën. Në Internet bëmë zhvillime të mëtejshme. Me produktet tona shfaqemi në rajone dhe shtete të reja, ndërkohë që seksioni ynë IT e shërben me zhvillime të vazhdueshme biznesin tonë kudo në botë. Rinovuam edhe Programin tonë bujar Motivues Profit Sharing. Nga dita në ditë pikësnyimi dhe misioni ynë kryesor është që kompania jonë të bëhet sa më e madhe e më e mirë.

Kurse gjëja më e rëndësishme është t'u bëjmë të ditur bashkëpunonjësve tanë se sa shumë e vlerësojmë punën e tyre — netët e vonëta, mëngjeset e herëta, takimet dhe kurset, 1/1-të dhe prezantimet e produkteve. I falenderojmë shumë për përpjekjet e shumta, punën e madhe dhe besimin! Jemi të angazhuar pas të ardhmes suaj, pasi Ju jeni forca lëvizëse e kompanisë!

Ju uroj gëzuar festat Juve dhe të dashurve tuaj! Ju uroj ta gjeni kohën për zhvillimin tuaj të brendshëm, përqendrohuni në gjërat që duken si të natyrshe, pasi kështu do të jeni në gjendje të kapërceni pengesat e menduara, në mënyrë që suksesi t'iu bëhet zakon me afat të gjatë!

Ju uroj një vit të ri të mrekullueshëm dhe të suksesshëm!

Me respekt të pafund
REX MAUGHAN

Prekja

Kur lindëm në këtë botë prekëm shumë mrekulli të saj. Një nga elementët vendimtar të ekzistencës sonë është prekja, forma e saj shpirtërore, materiale dhe mendore. Një libër i lexuar, një film i parë, disa fotografi të dashura e prekin menjëherë mendjen tonë, e cila e reflekton atë, e formon dhe e zhvillon botën, nga mrekullitë është e aftë të krijojë mrekulli akoma më të mëdha. Bota e prekjes është një botë shumëngjyrëshe, prekja e lëndës mund të jetë vendimtare në gjithë jetën tonë të ardhshme. Me prekje edhe ne mund ta formojmë botën, mund të krijojmë një botë të re, mund ta shumfishojmë atë.

Edhe ne të Forever-it kemi një prekje, të cilën e përthejmë nga fjala angleze Touch, dhe kjo prekje është vendimtare për të gjithë ne. Prekja e Forever-it, pra Touch of Forever është më shumë se lëndë, më shumë se një njësi e materializuar. Në këtë prekje janë përmbledhur njohuritë, puna dhe mendimet e shumë njerëzve. Është krijimi i një skuadre, i skuadrës së madhe Forever, e cila krijoi një mjet i cili mund të afrohet edhe ty në një distancë të arritshme.

Prekjet janë të rëndësishme në jetën tonë. Mund të marrim pjesë në një ekperiencë e cila na përcakton fatin e mëtejshëm. Touch of Forever, pra Prekja e Forever-it ka përcaktuar jetën e miliona njerëzve dhe e ka çuar drejt një jete më të bukur, më të lumtur, më gazmore dhe më të ekuilibruar.

Me një Prekje të tillë mund të ndryshosh mjedisin tënd, të ardhmen e shumë njerëzve dhe familjeve. Morre në dorë një mjet dhe mundësi fantastike nga miku, i njohuri yt — ata e morrën nga të tjerët, dikur disa vite më parë nga njerëz të cilët morrën përsipër ta ruanin për ty. Të gjithë Prekjen e parë e morrën nga një njeri, nga Rax Maughan drejtori i përgjithshëm i Forever International, një prekje me të cilën me miliona njerëz çojnë përpara bazat e një sistemi ekonomik që funksionon në mënyrë të përsosur. Shumë prej nesh, të cilët janë prekur nga Rex-i, mund të thonë se çojnë përpara një forcë të cilën ai e quan Forca e Dashurisë.


Për ne është vendimtare prekja e parë, Prekja e Forever-it, na përcakton ekzistencën, karrierën dhe na çon në botën e mrekullirave. Përpara nesh hapen mundësi të cilat deri tani nuk guxonim as t'i ëndërronim. Ka njerëz për të cilët kjo është mundësia e fundit. Sipas Attila Pataki-t, "Prekja e Fundit" që morrën nga jeta. Ju lutem, kujdesuni për të, vlerësoheni sepse na sjell një mundësi të paimagjinueshme, një botë të re e të mrekullueshme.

Atyre që janë prekur nga Touch of Forever, ju lutem që të prekin me të të gjithë në mjedisin e tyre rrethues, t'ia përcjellin të gjithëve këtë ndjenjë, sepse pa të bota është e varfër.



DR. SANDOR MILESZ

drejtor gjeneral

**ILDIKO ZAKAR** managere**PETER MAYER** senior manager
anëtare e President' s Club
drejtues programi

**Përpara shikimit pritës të
mijëra bashkëpunonjësve
tanë filloi Dita e Suksesit me
atmosferë fantastike e Forever
Living Hungari Shpk-s në
Arenës Sportive të Budapestit
me drejtimin e managere,
Ildiko Zakar, dhe senior
managerit, Peter Mayer. Pasi
u zbehën dritat me një muzikë
ritmike në sfond, në skenë
mbërritën dy drejtuesit e
programit dhe përshëndetën
publikun e madh.**

FOTOGRAFOI: ERIKA TOTH

Ëndrra bëhet realitet

Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** na tregoi zhvillimin e madh të kompanisë nga puna e periudhës së kaluar, duke përmendur njohuritë e gjithë distributorëve dhe duke përfunduar tek skuadra e Forever-it me zhvillimin më dinamik në Europë.

Dëgjua këngët e mrekullueshme të operetës me titull **Mbreti Istvan** nga **Veronika Nadasi, Kornel Czegledi, Tamas Demeter dhe Otto Magocs.** Përgëzime për shfaqjen e shkëlqyer.

Bashkëpunonjësja jonë senior managere, **Dr. Maria Debródi**, në leksionin e saj thirri vëmendjen për rreziqet që në muajt e vjeshtës dëmtojnë më shumë shëndetin tonë, përcaktoi veprimet dhe mjetet më të rëndësishme me ndihmën e të cilave mund të ruajmë shëndetin tonë, mund të mbajmë në formë trupin dhe shpirtin tonë.

Mjeku veteriner **Dr. Laszlo Mezősi** prezantoi një radhë përvojash interesante, gjatë të cilave kafshët tona shtëpiake, natyrisht me ndihmën e pronarëve të tyre, treguan përvojat e siguruar gjatë përdorimit të produkteve që mbrojnë shëndetin. Personazhet kryesore të prezantimit spektakolar u përshëndetën me duartrokitje të mëdha nga publiku, të cilat ata i pranuan me mirëkuptim. Falenderojmë zotin Mezősi dhe gjithë punonjësit e shëndetësisë që u ngjitën në skenë për punën e tyre kombëngulëse dhe të vazhdueshme.

Pasoi një nga momentet kryesore të Ditës së Suksesit, gjatë të cilit numri i madh i **supervisorëve dhe assistant managerëve** të sapokualifikuar morrën në skenë nga drejtori gjeneral medaljen e merituar dhe festuan së bashku me shokët e skuadrës, të afërmit dhe të njohurit e tyre.

Pas pushimit managerja **Piroska Lulatsi** foli rreth një mundësie, mundësisë së Forever-it, e cila bën realitet edhe ëndrrat më të paimagjinueshme: nëse i vendosim në radhën e duhur, përpunojmë një startegji të përshtatshme, kemi miq dhe të njohur të mirë, dhe krijojmë një skuadër e cila e realizon atë, kështu bëhet ëndrra realitet.

Senior managerët **Ilona Orosz dhe Dr. Zsolt Gönczi** në leksionin e tyre folën rreth një karakteristike shumë të rëndësishme të punës në Forever, rreth këmbënguljes. Nuk mjafton vetëm ta fillosh një detyrë, por duhet t'i shkosh deri në fund rrugës, duhet të gjydhësh gjithmonë e më shumë probleme të reja, duket të përballosh gjithmonë e më shumë sfida, dhe nëse i bëjmë të gjitha këto, atëherë e arrijmë atë që dëshironim aq shumë.

Skena ndërroi ritëm, mes dritave të forta aty u shfaqën kërcimtarët e mrekullueshëm të **Positive Force** dhe një nga yjet e Hungarisë, Magdolna Ruzsa, e cila e mahniti publikun me



zërin e saj. Përgëzime dhe i urojmë suksese të mëtijshme në fillim të karrierës së saj.

Pas shfaqjes së jashtëzakonshme në skenë përshëndetëm dhe vlerësuam anëtarët e **Klubit të Sundimtarëve**, pastaj erdhën managerët e rinj dhe morrën medaljet e tyre nga drejtori gjeneral. Si përfundim në skenë

përshëndetëm senior managerët, **Szilard Mrakovics dhe Emőke Csordas**, të cilët falenderuan linjën e tyre të sipërme dhe të gjithë ata që i ndihmuan në këtë punë kaq të bukur.

Soaring managerët **Sandor Toth dhe Edina Vanya** na prezantuan biznesin e tyre, kompaninë Forever,

prodhuesen kryesore dhe tregëtuesen numër një të aloe vera-s në botë. Në leksionin e tyre të përgatitur me shumë precizitet dhe pikëpamje të gjerë, të gjithë patën mundësinë të shohin pamjen e të ardhmes të cilën ata e dinë dhe e ndjejnë me siguri.

Safir manageri dhe anëtar i President's Club, **Jozsef Szabo**, në leksionin e tij



të hapur dhe që i drejtohej ndjenjave të të pranishmëve, foli për thelbin e punës sonë në Forever, faktorin vendimtar të saj, për NJERIUN. Na bëri të qartë se çelësi i gjithçkaje është në dorën tonë, mendimi dhe vendimi ynë e çon mëtej flamurin e Forever-it të cilin ai e solli këtu në Hungari. Çojeni mëtej dhe ngriheni më lart këtë flamur! Faleminderit për leksionin e shkëlqyer.

Michael Strachowitz mbërriti si i njohur në skenën e Forever-it, dhe bashkëpunonjësit tanë e pranuan me shumë kënaqësi që mund të mësojnë përsëri prej tij. Zoti Strachowitz me stilin e tij të zakonshëm pak humoristik na bëri të qartë faktorët, pa mënjanimin e të cilëve nuk mund të ndërtohet një rrjet stabil. Kujdesi për blerësit është një nga shtyllat bazë të ndërtimit të tregut

stabil, dhe jemi me shumë fat që këtë patëm mundësi ta mësonim nga një lektor me njehuri dhe personalitet kaq të madh. Si mbyllje e Ditës së Suksesit në skenën e Forever-it përshëndetëm assistant supervisorët e rinj të cilët do të jenë vendimtar në muajt dhe vitet e ardhshme në tregun e Forever-it. I përgëzojmë të gjithë për hapin e hedhur!







**RAJKA BULJIN****SAVA BULJIN**senior managerë
drejtues programi

Sapo u ndamë nga rrezet e fundit të diellit të verës dhe tek ne mbërriti me pikësnyime më të bukura e të shkëlqyera vjeshta e FLP-s. Drejtuesit e aktivitetit tonë Success Day të parë të vjeshtës ishin senior managerët, Rajka dhe Sava Buljin. Ishte një rastësi e mrekullueshme për ta që atë ditë festonin edhe përvjetorin e martesës. Në emër të FLP-s i urojmë çiftit Buljin edhe shumë përvjetore të lumtura martese dhe i falenderojmë për drejtimin e shkëlqyer të aktivitetit tonë.

Punë dhe mënyrë jetese e pavarur

Bashkëpunonjësit tanë të pranishëm u përshëndetën nga drejtori rajonal i FLP

Serbisë, **Branislav Rajic**. Në hapjen e tij na kujtoi programet motivuese të FLP-s dhe paraqiti disa të reja në veprimtarinë e kryer në rajonin e FLP Serbisë. Në flamurin e kompanisë sonë shfaqet një simbol i ri dhe me këtë nisemi me forca të reja drejt realizimit të niveleve edhe më të larta të planit marketing të Forever Living Products.

Këngët e bukura në gjuhën serbe të grupit „**SON CUBA SON**” na e sollën shumë afër Kubën e largët. Në ritmin dinamik latino-amerikan të muzikës së tyre të gjithë u ngritën në këmbë dhe filluan të kërcenin në sallën ceremoniale të Pallatit të Sindikatave. E falenderojmë grupin kubanez për shfaqjen e tyre të shkëlqyer.

Përvojat me produkte të konsumatorëve dhe mjekëve tanë është një nga pjesët më të rëndësishme të programit të çdo Success Day. Gjatë kësaj vërtetohet përsëri cilësia e shkëlqyer e produkteve tona, të cilat na ndihmojnë nga dita në ditë në luftën e bërë për përmirësimin e cilësisë së jetës. Falenderojmë gjithë bashkëpunonjësit dhe mjekët tanë për guximin dhe iltërsinë me të cilën ndanë përvojat e tyre me ne.

Kjo pjesë e programit u drejtua me mjeshtri nga **Dr. Snezana Kontra**.

Për njerëzit gjëndja e mirë shpirtërore dhe shëndeti është si drita e diellit për bimët. Falenderojmë **Dr. Snezana Tomanovic-in** për këshillat e saj të shkëlqyera në lidhje me faktin që me ndihmën e produkteve të FLP-s mund të jetojmë një jetë cilësore.

Pas kësaj në skenë përshëndetëm bashkëpunonjësit tanë të sapokualifikuar **assistant supervisor, supervisor, assistant manager dhe manager**. Atyre u uruam suksese të shumta në punë.

Forever Living Products me programet e saj të shumta motivuese ofron një mbështetje të shkëlqyer për përvetësimin e ekonomisë së tregut dhe mundësive të mrekullueshme të punës. Nga viti 2006 aktivitetet tona me emrin Holiday Rally u bënë pjesë e programeve zyrtare të kompanisë sonë dhe përbëjnë një motivim akoma më të madh për ata që hedhin hapat e para në FLP. Për mundësinë e pjesëmarrjes në këto aktivitete ka meritë të madhe **Andrea dhe Tamas Budai**, sepse e dalluan mirë spektrin e gjerë të ekonomisë së tregut të FLP-s.

Bashkëpunonjësi ynë manager **Slobodan Antonijevic** e lejoi FLP-



FOREVER LIVING
PRODUCTS SRBIJA
DANI USPEHA
28.10.2006.



n në jetën e tij vetëm pas një lufte të gjatë. Vendimi i madh lindi kur i hyri si tregëtar realizimit të Planit Marketing Forever. Gjatë leksionit të tij vërtetoi se përvojat personale të siguruara gjatë konsumimit të produkteve përbëjnë një shkallë të rëndësishme në radhën e shkallëve që të çojnë drejt një

mundësie të madhe pune dhe një stili të pavarur jete.

Në skenën e aktivitetit tonë Success Day përshëndetëm distributorët më të suksesshëm, anëtarët e **Conquistador Club** të muajit të kaluar, të cilët e rritën shumë veprimtarinë në krahasim me

muajin e mëparshëm dhe me këtë e merituan anëtarësinë e Klubit. I përgëzojmë anëtarët e Klubit të Sundimtarëve dhe u urojmë kualifikime të mëtejshme.

E ardhmja e ekonomisë sonë fshihet në marrëdhëniet me njerëzit dhe bazohet në angazhimin sa më të



madh pas punës. Qëllimi i secilit prej nesh është që punën tonë ta vendosim mbi këto baza të forta dhe ta rrisim sa më shumë angazhimin tonë. Ndërtimi i rrjetit FLP është puna e shekullit njëzetënjë, sepse nëpërmjet produkteve me cilësi të shkëlqyer dhe një rrjeti shpërndarës të përsosur i vendos në vend të parë

mundësitë njerëzore. E falenderojmë shumë lektorin mysafir **Dr. Dusan Pavlovic** dhe jemi të sigurt se në bazë të leksionit të tyre shumë vetë do të arrijnë suksese të reja në punën dhe jetën e tyre të përditshme.

Si mbyllje të aktivitetit Success Day **assistant supervisorët** tanë të rinj

morën medaljet e merituar. U uruam suksese të shumta në arritjen e shkallëve të reja të Planit Marketing FLP.

BRANISLAV RAJIC
drejtor rajonal i FLP Serbisë





TANJA JAZBINSEK
senior manager
drejtuese programi

Përsëri kaloi një vit, nga pemët bien gjethet, fryn era e vjeshtës, por prapë ngrohemi nga rrezet e diellit. Më 11 nëntor, të shtunën, dielli shkëlqente aq shumë sa që e ndriçoi plotësisht sallën e madhe GH Union. Është e pabesueshme që frymë qiririn e pestë në tortën e përvjetorit. Koha kalon shpejtë. Thonë se kalon shpejtë kur e ndjemë mirë veten. Çdo vit, pas një aktiviteti të tillë, ndaloj për një moment dhe bëj një bilanc të rezultateve. Dhe çdo vit më duhet më shumë kohë për të mbledhur të dhënat.

Forever ofron një të ardhme më të bukur

Në skenën e sallës së mbushur plot këngëtarja **Katja Lesjak dhe grupi Skuter** kënduan për të mbledhurit. Shfaqja e tyre dinamike na solli në qejf dhe na përgatiti për punën serioze. Drejtuesja e programit, senior managerja, **Tanja Jazbinsek**, përshëndeti me përzemërsi publikun festues. Përshëndeti në mënyrë të veçantë mysafirët e dashur, ndërmjet tyre drejtorin gjeneral, **Dr. Sandor Milesz**, drejtorin rajonal serbe, **Branislav Rajic**, drejtorin rajonal boshnjak, **Slavko Paleksic**, dhe gruan e tij, drejtorin rajonal kroat, **Laszlo Molnar**, dhe gruan e tij **Branka**, drejtorin e zyrës së Debrecenit, **Kalman Posa**, dhe gruan e tij **Marti**, drejtorin e zyrës së Szekesfeharvit, **Attila Fodi**, drejtoreshën e financës, **Gabriella Veber Rokasne**, dhe burrin e saj **Sandor**, si dhe lektorin tonë, **Tamas Biro**.

Tanja kishte edhe një surprizë për ne: ajo ftoi në skenë miqtë dhe bashkëpunonjësit e **Jozica dhe Miran Arbeiter**-it. Ndërkohë që disa filluan të supozonin se çfarë do të ndodhte, u dëgjua kënga: "Kanë kaluar pesë vite që kur u nis biznesi, mësuam së bashku, të gjithëve iu bë më mirë, dhe është e sigurt se Forever është më e mira, sepse u ofron të gjithëve një të ardhme më të bukur. . .". Bashkëpunonjësit tanë të shkëlqyer natyrisht kënduan këngën që tani u bë himni i zyrës slovene. Publiku e përshëndeti me duartrokitje të madhe

shfaqjen. Të përmbledhurat në tekstin e këngës u përforcuan edhe nga mysafiri ynë më i dashur.

Në skenë me skuadrën u bashkuan edhe drejtori gjeneral, **Dr. Sandor Milesz**, dhe drejtori rajonal sloven, **Andrej Kepe**. E dinit se sa të suksesshëm jemi? Jo? Atëherë ta dini se ne jemi zyra me zhvillimin më dinamik në rajon, në bazë të rezultateve arritëm vendin e tretë.

Dr. Sandor Milesz me fjalët e tij lavdëruese na dha forca dhe entuziazëm të mëtejshëm për t'u ngjitur edhe më lart, për t'u bërë edhe më të suksesshëm, dhe përpara të gjithave për të punuar edhe mëtej me të njëjtin entuziazëm. E felenderojmë mysafirin tonë nga Budapesti për vizitën dhe fjalët e tij nxitëse. I premtojmë që nuk kemi për ta zhgënjyer.

Edhe mysafiri ynë i mëpasshëm kishte ardhur nga Budapesti. Senior manageri, **Tamas Biro**, foli për fillimet dhjetë vjet më parë. Nuk ishte e lehtë. Nuk kishte asnjëri, dhe e frikësonin se do të zhytej thellë dhe nuk do të kishte asnjëherë sukses. . . Punoi duke e bërë natën ditë, morri përsipër çdo punë, madje punoi edhe në vend të drejtorit, vetëm që pagesën e tij nuk e morri asnjëherë. Rreth Hawait as nuk ëndërronte. Por prapë, çfarë e shtyu që ta lejë punën e atëherëshme dhe të zgjedhë FLP-n pothuajse të panjohur? Dhe shikoni se ku ndodhet sot. Me

angazhim dhe guxim arriti nivelin e senior managerit, dhe jam i bindur se është gjithmonë e më afër nivelit të mëpasshëm. Hawai sot u bë realitet. Ta ndjekim atë, edhe ne do të kemi sukses. E falenderojmë Tamas-in për leksionin e shkëlqyer.

Çdo ditë dëgjojmë të paktën dhjetë lajme. Cilat janë lajmet tek ne, për këtë na informoi drejtori rajonal sloven, manageri **Andrej Kepe**. U pasuruam me dy produkte të reja. Na prezantoi efektin e mirë dhe përdorimin e tyre. Dhe meqë lamë pas një vit të suksesshëm, na bëri të njohur edhe rezultatet tona. Sa bashkëpunonjës të rinj kemi, sa vlerësime ndamë për punën e kryer. . . Mund të them vetëm që jemi të suksesshëm!

E dini se cilat janë dy produktet që na vijnë gjithmonë për ndihmë gjatë pushimeve verore. Jo? Atëherë pyesni grupin Skuter. Ata e dinin se përgjigjja është First dhe Aloe Sunscreen që përdoren edhe nga ata. Duke kënduar dy këngë të tjera na mbushën me energji, dhe kështu u përgatitëm plotësisht për ndarjen e vlerësimeve që u takojnë më të mirëve.

Në skenë mbërritën **supervisorët, assistant managerët, managerët, një senior manager** dhe punonjësit që plotësuan **programin e makinës** për të marrë vlerësimet dhe çelësat e tyre. Përgëzuam bashkëpunonjësën tonë **Tatjana Jazbinsek** për arritjen e nivelit të senior managerit, kurse bashkëpunonjësin tonë **Tomislav Brumac** për plotësimin e kushteve të programit të makinës!

Dhe jemi krenar edhe për të vlerësuarit e tjerë. Shkoni edhe më lart. Natyrisht,

sado lart të ngjitemi, pak ëmbëlsirë nuk na bën keq. Mbërriti torta e përvjetorit me pesë qirinj të ndezur. Bashkë me **Katja Lesjak**-un i frymë qirinjtë dhe kënduam "Gëzuar përvjetorin FLP". Në pushimin e merituar na kënaqi shumë e ngrëna. . .

Të shplohur u kthyem në sallë, ku në skenë ndodhej drejtuesja e programit **Tanja Jazbinsek**, e cila thirri pranë vetes surprizën e Success Day. Tek ne erdhi humoristi sloven më i njohur, Jaka Sraufciger. Nuk besoja se dikush mund të më bëj kaq shumë për të qeshur. Dhe po mendoja se përse ka gjithmonë e më pak kohë për shfaqjet. Jaka, i cili gjithashtu i përdor produktet e FLP-s, tregoi se çfarë i tërheq më shumë meshkujt. Përgjigjja: Multi Maca. Pastaj këndoi këngën e shkruar për FLP-n.

Ndërkohë që mezi merrnim frymë nga të qeshurit, ia dha fjalën bashkëpunonjësës sonë senior managere nga Kroacia, **Ivanka Mill-Riljak**, e cila në leksionin e saj me titull "Si e fillova?" foli rreth fillimeve të saj.

FLP-ja na i realizoi të gjitha ëndrrat. Tregoi se si filloi, si u nis në këtë rrugë, foli edhe rreth pikësnyimeve që dëshiron të arrijë pikërisht me ndihmën e FLP-s. E falenderojmë që ishte me ne.

Pranvera është akoma larg dhe bletët pushojnë, por bashkëpunonjësi ynë soaring manager, **Tomo Brumec**, punon me vullnetin e një blete. Edhe në vjeshtë! Pronari i çelësit të makinës së re në leksionin e tij interesant rreth produkteve të kosheres së bletës zbuloi sekretet e produktit tonë Forever Bee Honey. Thjeshtë: më i miri. E dinit që siguron edhe gjumë të qetë? Tomo,

faleminderit për leksionin e ri të mrekullueshëm.

Kalcium? Kush tjetër do të na fliste rreth efekteve të mira të kalciumit përveç bashkëpunonjësit tonë manager, **Miran Arbeiter?** Miran tha shumë gjëra të reja e me vlerë rreth Forever Kalcium-it. . . Me thënë të drejtën, deri të shtunën nuk dija shumë rreth rëndësisë së këtij elementi në organizmin tonë. Përshebull në rregullimin e ritmit të zemrës. Në këtë botë të përsheptuar e konsideroj tepër të rëndësishme këtë.

Përvojat! Përvojat që ndihmojnë punën tonë. Pjesën e programit përvojat me produkte e drejtoi bashkëpunonjësja jonë managere, Jozica Arbeiter. Sipas meje me shumë përzemërsi. Mësuam shumë të reja, dhe e falenderojmë Jozica-n për origjinalitetin dhe ndihmën e saj.

Në vazhdim në skenë u ngjitën përsëri drejtoret e ardhur në aktivitetin tonë dhe punonjësit e FLP Slovenisë. Dëshiroj t'u shpreh të gjithëve falenderimet e mia.

Dhe meqë dalëngadalë po i afrohem fundit të aktivitetit tonë, skena u zu nga "dy pikëshit". I përgëzoj të gjithë dhe u uroj që të fluturojnë edhe më lartë në krahët e shqiponjës.

Përgëzoj drejtuesen e aktivitetit tonë, bashkëpunonjësën tonë senior managere, Tanja Jazbinsek, për drejtimin e shkëlqyer të programit të Success Day. Jam i bindur se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. U uroj të gjithëve të fluturojnë sa më lart dhe të arrijnë qëllimet e tyre. Mos ndaloni asnjëherë, mos u dorzoni kurrë. "Njeriun e shtyn diçka të fluturojë dhe nuk ka për t'u zvarritur kurrë në tokë."





**VASILIJ GOLUB** managere**ZSOLT PÖLHE** manager
drejtues programi

Kanë kaluar shtatë vjet që atëherë kur më 1999, në Zagreb, në rrugën Gundulic filloi punën e saj FLP Kroacia. I shkuam deri në fund rrugës, nga çerdhja deri në kopsht, dhe më në fund erdhi koha të shkojmë në shkollë.

FOTOGRAFOI: DARKO BARANASIC

Vlerat njerëzore dhe besimi

Drejtuesit e ditës sonë të suksesit ishin managerët nga Zagrebi, **Vasilija Golub dhe Zsolt Pölhe**. Në përshëndetjen e tyre treguan se u njohën me njëri-tjetrin në hapjen e zyrës së FLP-s në Zagreb, lidhën miqësi e cila do të jetojë "Forever".

Pasi përshëndetën punonjësit dhe mysafirët, kënduam së bashku me të njohurën tonë të vjetër, **Latinka Ruski**. Kjo ishte shfaqja e saj e tretë tek ne. Kur dy vjet më parë u ngjit për herë të parë në skenë, gjëja më e rëndësishme për të ishte karriera. Tani është e martuar dhe e do shumë vajzën e saj pesëmbëdhjetë muajshe.

Drejtori rajonal kroat **Dr. Laszlo Molnar** në përshëndetjen e tij shpjegoi se përse e ndryshuam ditën e Jonathan-it në ditë Suksesit, dhe tregoi simbolin e ri të kompanisë sonë, shqiponjën. Pas kësaj thirri në skenë drejtorin gjeneral **Dr. Sandor Milesz**, i cili na përgëzoi për përvjetorin e shtatë, pastaj mbajti kroatisht leksionin e tij interesant nga i cili mësuam se drejtori i përgjithshëm i FLP-s, **Rex Maughan** e feston ditëlindjen e tij në të njëjtën kohë me atë të FLP-s kroate. Lindim dhe mbërrijmë në Tokë me një qëllim dhe detyrë të caktuar. Njeriu që kur lind rritet, mëson, ndjek një drejtim që të arrijë diçka, që të bëhet dikush. Dhe lindin edhe njerëz të cilët me punën e tyre janë të aftë të përcaktojnë jetën e të tjerëve. Rex Maughan krijoi sistemin që mbështetet

në vlerat njerëzore dhe në besim. Rex ka bërë shumë të mira për njerëzit, dhe megjithëse s'ka marrë çmim Nobel — për të dashuria e këtyre njerëzve vlen më shumë se sa ky çmim.

Pasi Dr. Miesz na uroi shëndet dhe suksese të shumta në punë, së bashku me **Dr. Laszlo Molnar** ndezën qirinjtë e tortës së përvjetorit, ndërkohë që në skenë u ngjitën me urime drejtori i zyrës së Lubjanës, **Andrej Kepe**, së Beogradit, **Branislav Rajic**, së Podgoricës, **Alaksandar Dakic** dhe drejtori i zyrës së Debrecenit, **Posa Kalman**.

Në vazhdim erdhi leksioni i **Dr. Terezia Samu-t**, të cilën disa prej nesh patën mundësinë ta dëgjonin edhe në Holiday Rally-n e Porecit. Përvojat e kirurgjes specialiste që është prej dhjetë vitesh distributore janë tepër me vlerë për të gjithë ne. Mësuam se Çfarë dhe Si t'ua prezantojmë blerësve, si t'ua ofrojmë mundësinë e biznesit, dhe jo në radhë të fundit si t'i informojmë rreth rëndësisë së parandalimit dhe përdorimit të plotësuesve ushqimor. E falenderuam mjeken Dr. Samu për leksionin e saj interesant dhe mësimdhënës.

Paraqitja e përvojave me produkte edhe tani në mënyrë sovranë u drejtua nga **Dr. Albert Keresztesyi**. Në skenë ndoqën njëri-tjetrin ata që i përdorin prej shumë vitesh produktet



tona dhe shkëmbyen me ne përvojat e tyre të pasura të siguruar gjatë këtyre viteve. Dr. Kereszteni me pyetjet dhe rekomandimet e tij na ndihmoi të kuptojmë rëndësinë e parandalimit dhe konsumimit të vazhdueshëm të produkteve. I falenderojmë të gjithë ata që shkëmbyen përvojat e tyre me ne.

Latina Ruski na argëtoi me këngë me rastin e përvjetorit, dhe atmosfera e ngrohtë mbeti edhe në pushim kur po bisedonim pranë tortës.

Pjesa e dytë e programit u hap nga artistët e **studios së kërcimit TT Exclusive, Adrijana dhe Petra**, të cilat kërcyen një këngë tepër interesante të Christine Aguilere-s.

Nëse ka njeri që e kishte tepër të vështirë ndërtimin e biznesit FLP, ajo është zonja **Mirjana Mesaros Romic**. Fillimi i saj në FLP përbëhej nga shpërngulja në mjedis tjetër, ndërrimi i vendit të punës, njerëz të rinj dhe edukimi i vajzës së saj. Por Ajo prapë tha: "Më jepni një recetë, dhe po ua pjek ëmbëlsirën!" Në recetë ndodhej edhe lista e emrave rreth rëndësisë së të cilës dëgjuam në këtë leksion tepër me vlerë.

Edhe **Manda Korenic** hyri në klubin e madh të FLP-s. Në këto ditë festoi përvjetorin e gjashtë të punës së saj në FLP. Pronarja e qendrës së bukurisë dhe shëndetit në Pula i përdor produktet e FLP-s edhe gjatë punës së saj. Në vend të parë ndodhet kozmetika dhe

koleksioni Sonya, kurse programi i shëndetësisë e ndihmon "nga brenda" bukurinë. Si të bëhemi të suksesshëm, si t'i arrijmë qëllimet tona? Përse zgjodhët pikërisht FLP-n? Sa shumë ofron: shëndet, siguri materiale, kujdeset rreth produkteve, dizenjot, depozitimit, pagesave, cilësisë. . . Po ne? Ne i përdorim dhe rekomandojmë produktet. Prandaj e zgjodhi Manda FLP-n.

Është një nder i madh të marrësh vlerësim në Ditën e Suksesit të përvjetorit nga drejtuesi më i lartë i rajonit. Në skenë përshëndetëm më të suksesshmit dhe sponsorët e tyre. Dhe u përshëndetëm nga shumë fytyra të qeshura dhe të gëzuara.



Marija Novak Istok është pjesëmarrësja dhe lektorja e përhërëshme e aktiviteteve tona. Njohuritë e saj i ndan me ne gjithmonë në mënyrë të saktë, të qartë dhe profesioniste. Një gjë është e sigurt që gjatë ndërtimit të biznesit hapat e para janë më të vështirat. Si t'i hedhësh ato me sa më pak rrëzime dhe disfata — për këtë bënte fjalë ky leksion i jashtëzakonshëm.

Në lidhje me biznesin MLM ekziston idea e gabuar se me të merren vetëm njerëzit pa të ardhme dhe që vujanë për bukën e gojës. Jeta e safir managerit, basketbollistit të dikurshëm, juristit të diplomuar, drejtuesit të njohur të programeve të radios dhe

televizionit, **Dr. Adolf L. Kosa-s**, ishte e suksesshme edhe përpara FLP-s. Dëgjuam një leksion tepër mësimdhënës se përse u bashkua me ne, se si ndryshoi gjatë kësaj kohe, çfarë arriti dhe çfarë ëndrrash iu plotësuan në vitet e

FLP-s. Suksese dhe disfata, njerëz — punë skuadre, gëzimi për sukseset e veta dhe të tjerëve, njohja me njerëz me të cilët ndoshta nuk do të ishte takuar kurrë — kjo e bën të mrekullueshme dhe tepër të pasur jetën e FLP-s.

Pas leksionit të Adolf-it **Dr. Laszlo Molnar** prezantoi punonjësit e zyrës së FLP-s së Zagrebit të cilët me punën e tyre të madhe sigurojnë gjithë

atë që konsumatorët dhe anëtarët presin nga zyra.

Dalëngadalë aktiviteti i përvjetorit tonë të shtatë po i afrohej fundit. **Dr. Sandor Milesz** duke na uruar shëndet dhe suksese në punë, u dha medaljet **assistant supervisorëve**, pra bashkëpunonjësve tanë të cilët duke siguruar dy pikët e tyre të para u nisën në rrugën e suksesit. . .

Dita e ardhshme e Suksesit do të mbahet më 16 dhjetor në tetarin Exit, drejtuesit e të cilës do të jenë managerët nga Zagrebi, Margareta dhe Mirijan Sukser.

DR. LASZLO MOLNAR
drejtori rajonal i FLP Zagrebit



Klubi i Sundimtarëve



Dhjetë
shpërndarësit
e parë sipas
pikëve
personale
dhe të non-
managerit

CONQUISTA Shpërndarësit më të su



HUNGARIA



SERBIA, MALI I ZI



1. Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné
2. Juhász Csaba dhe Bezzeg Enikő
3. Gulyás Melinda
4. Soós István dhe Soósné Zelei Mária
5. Zakar Ildikó
6. Siklósné Dr. Révész Edit dhe Siklós Zoltán
7. Senk Hajnalka
8. Bánhidý András
9. Dr. Kiss Ferenc dhe Dr. Nagy Ida
10. Jancsik Melinda

1. Ocokoljić Danijela
2. Milanović Ljiljana
3. Lomjanski Stevan dhe Lomjanski Veronika
4. Buruš Marija dhe Buruš Boško
5. Ocokoljić Zoran
6. Ostojić Boro
7. Jakupak Vladimir dhe Jakupak Nevenka
8. Dragojević Goran dhe Dragojević Irena
9. Svenderman Hajnalka dhe Svenderman Stevan
10. Stojiljković Srba

DOR CLUB

ksseshëm të muajit tetor 2006



KROACIA



BOSNIA DHE HERCEGOVINA



SLOVENIA



1. Ciler Dominik dhe Ciler Stefaniya
2. Sukšer Margareta dhe Sukšer Marijan
3. Golub Vasilija
4. Žutinić Momo dhe Žutinić Mare
5. Jezl Vladimir dhe Jezl Irena
6. Golubović Karmela dhe Golubović Roman
7. Baksa Dušanka dhe Baksa Željko
8. Curić Ljubo dhe Curić Grozdinka
9. Semialjac Patrik
10. Boljat Stela dhe Boljat Zdenko

1. Dragić Meliha dhe Dragić Dragan
2. Misić Cveta
3. Njegovanović Vasselije
4. Bulić Drenka dhe Bulić Djuro
5. Njegovanović Svetlana
6. Catić Gaibija dhe Catić Munira
7. Kundert Aida dhe Kundert Božidar
8. Varajić Zoran dhe Varajić Snežana
9. Djordjević Radmila
10. Alić Amina dhe Alić Fuad

1. Arbeiter Jožica dhe Dr. Arbeiter Miran
2. Bizjak Marija
3. Bigec Danica
4. Novak Mihaela
5. Hladnik Barbka
6. Brumec Lovro
7. Jazbinsek Kim
8. Brumec Natalija
9. Jagodić Joza dhe Jagodić Tone
10. Bole Natali dhe Bole Matej

FLP Hungaria, Kroacia, Bosnia-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, Sllovenia

Të gjithë në rrugën drejt suksesit

Nivelin e senior managerit e arritën

Fittler Diána

Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné



Nivelin e managerit e arritën

Eszes Emil dhe Eszes Emilné
Fridrik Eszter
Jancsik Melinda
Kocsi Katalin
Kovács György dhe
Kovácsné N. Bernadett

Kósa János dhe
Kósa Jánosné
Stojilković Srba
Svenderman Hajnalka dhe
Svenderman Stevan
Turjačanin Snežana

Tóth Zoltán dhe
Horváth Judit
Urbán Éva
Vorgučin Rac Aranka dhe
Vorgučin Boško



Nivelin e assistant managerit e arritën

Banjanac Veljko dhe
Vujić Marija
Duduković Goran dhe
Duduković Jelena
Erdődi István dhe
Erdődiné Molnár Zsófia
Kara Katalin
Kasza Csaba
Koncz Tiborné dhe
Koncz Tibor

Kovács Tibor
Németh Mónika
Palotás Zoltán
Rácz Anita
Rácz Ildikó
Rakovac Radmila dhe
Rakovac Budimir
Rankov Siniša dhe
Rankov Vera
Samu Tibor dhe

Lázár Katalin
Simon János
Tesla Branko dhe
Tesla Ester
Tóth Andrea
Vukić dr. Radenko dhe
Vukić Radenka
Žica Milena dhe
Žica Dušan



Nivelin e supervisorit e arritën

Adamik Mária
Aleksić Slavica dhe Aleksić Rade
Andó Zoltán dhe Blaskó Ildikó
Bakonyi Judit dhe Nánai Krisztián
Balogh Tamás
Balogh Edina
Baloghné Mónos Csilla dhe
Balogh József
Bohusné Fekete Zsuzsa dhe
Bohus György
Brankov Branimir
Bulić Drenka dhe Bulić Đuro
Böngyik Istvánné dhe Böngyik István
Bódi István
Csávás Lajos dhe Rendik Ilona
Cuka Marija dhe Cuka József
Dimitrijević Mirjana dhe
Dimitrijević Nenad
Dinya Tímea
Dobó Adrienn
Dobó József
Dosković Marija dhe Dosković Jovan
Dosztig Ildikó
Dr. Cserhalminé Demeter Edina dhe
Dr. Cserhalmi Tamás
Dr. Hegedűs Balázsne dhe Légrádi Krisztina
Dr. Máhr Károly dhe Bali Viktória
Dr. Nagy Tiborné dhe Dr. Nagy Tibor
Dr. Perdukné Tárczy Viktória dhe

Dr. Perduk András
Dr. Schusztér W. András
Dr. Szlovenszki Adrienn
Dóry Erika
Eraković Mirjana dhe Eraković Radomir
Eszes Tamás
Fekete Béla dhe Feketéné Nagy Julianna
Gáborné Márton Judit
Gara Balázs
Garami Marietta
Ghisini-Szöllősy Andrea dhe
Juhász János
Gulyásné Tamás Edit dhe
Gulyás József
Hladnik Barbka
Horváth Attiláné dhe Horváth Attila
Jandrić Zana dhe Hrnčić Predrag
Jovanović Mirjana dhe
Jovanović Dragan
Juhász Gabriella
Kékesi Ferenc
Kékesi Gábor
Kajári Zoltán dhe Heinczinger Petra
Kányó Beatrix
Karikó Józsefné
Keneseiné Dr. Milics Margit dhe
Kenesei Gyula
Kertész Zsoltne dhe Kertész Zsolt
Király Ida

Kiss Teréz Anna
Kocsis Jánosné
Kovács Péterné
Kutassy Lászlóné dhe Kutassy László
Láng Andrásné dhe Láng András
Mexné Táncos Éva
Miskolczy Szonya dhe Nagy Sándor
Molnár Ernő dhe Molnár Ilona
Muhari Andrea dhe Farkas Zsolt
Mustapić Natalija dhe Mustapić Nikica
Némethné Besenyei Erika dhe
Németh József
Nagy Gábor
Nyitrai Németh Katalin dhe
Nyitrai Péter
Óri Tibor
Pappné Bekker Julianna dhe
Papp József
Patuzzi Anett
Paunović Zlata
Pavlović Aleksandar dhe
Pavlović Biljana
Ponyeczki György Gyula
Popovics Annamária Gábor
Prčić Jasmina dhe Prčić Dejan
Póczos Andor dhe Póczosné Jákfalvi Szilvia
Rajković Slobodan
Rankov Bojan
Róth András



Sándor Tibor
Schusztar Anikó
Schwarcz Attila
Semialjac Patrik
Simon Károly
Simon Istvánné
Starovlah Zorica
Steigler Hajnalka
Szabó Ilona

Szeitnérné Mondy Katalin
Szlovenczi Lászlóné
Szócs Péter
Szűcs Noémi dhe Dinya László
Szűcsné Rapi Mária
Takács Sándorné
Takács Judit
Tausz Krisztián
Toldi Tijana

Turjačanin Slaviša
Tóth Gergő
Lieber Brigitta
Vásárhelyi Csaba
Varga Csaba
Vendrey Anita
Veréb Annamária
Vučković Dušan
Wicha Erzsébet

Fituesit e programit motivues për blerjen e makinës



Niveli I

Atanasov Divan
Ádám Szöllősi Cecília dhe Ádám István
Babály Mihály és Babály Mihályné
Bakó Józsefné dhe Bakó József
Bakóczy Lászlóné
Bali Gabriella dhe Gesch Gábor
Barnak Danijela dhe Barnak Vladimir
Bánhegyi Zsuzsa dhe
Dr. Berezvai Sándor
Becz Zoltán dhe Becz Mónika
Bégi Zsuzsanna
Bertók M. Beáta dhe Papp-Váry Zsombor
Botis Gizella dhe Botis Marius
Bognárné Maretics Magdolna dhe
Bognár Kálmán
Bojtor István dhe Bojtorné Baffi Mária
Brumec Tomislav
Budai Tamás
Császár Ibolya Tünde
Csepi Ildikó dhe Kovács Gábor
Csuka György dhe Dr. Bagoly Ibolya
Csürke B. Géza dhe Csürke Bálintné
Darabos István dhe Darabos Istvánné
Davidović Mila dhe Davidović Goran
Dr. Csiztu Attila dhe Csiztuné Pájer Erika
Dr. Dóczy Éva dhe
Dr. Zsolczi Sándor
Dr. Farády Zoltán dhe Dr. Farády Zoltánné
Dr. Farkas Margit dhe Szabó János
Futaki Gáborné
Dragojević Goran dhe Dragojević Irena
Fejlesztés Ferenc dhe
Fejlesztésné Kelemen Piroksa
Gulyás Melinda
Hajcsik Tünde dhe Láng András
Halomhegyi Vilmos dhe
Halomhegyiné Molnár Anna
Haim Józsefné dhe Haim József
Hanyecz Edina
Hári László dhe Hegyi Katalin
Heinbach József dhe Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Jakupak Vladimir dhe Jakupak Nevenka
Juhász Csaba dhe Bezzeg Enikő
Kása István dhe Kása Istvánné
Keszler Ollós Mária dhe
Keszler Árpád
Kibédi Ádám dhe Ótós Emőke
Knisz Péter dhe Knisz Péterné
Dr. Kovács László dhe Dr. Kovács Lászlóné
Kovács Zoltán dhe Kovácsné Reményi Ildikó

Kuzmanović Vesna dhe Kuzmanović Siniša
Lapicz Tibor dhe Lapiczné Lenkó Orsolya
Mayer Péter
Markó Mária dhe Markó Antal
Márton József dhe Mártonné Dudás Ildikó
Mičić Mirjana dhe Harmos Vilmos
Milovanović Milanka dhe
Milovanović Milislav
Milanović Ljiljana
Molnár Attila
Molnár Zoltán
Dr. Molnár László dhe
Dr. Molnár Stantić Branka
Nakić Marija dhe Nakić Dusan
Mišić Dr. Olivera dhe Mišić Dr. Ivan
Mrakovics Szilárd dhe Csordás Emőke
Dr. Németh Endre dhe Lukácsi Ágnes
Németh Sándor dhe
Némethné Barabás Edit
Oczkoljic Daniela
Oczkoljic Zoran
Orosz Ilona dhe Dr. Gönczi Zolt
Orosz Lászlóné
Ostojic Boro
Papp Tibor dhe Papp Tiborné
Dr. Pavkovics Mária
Perina Péter
Petrović Milena dhe Petrović Milenko
Radóczy Tibor dhe Dr. Gurka Ilona
Ramháb Zoltán dhe Ramháb Judit
Révész Tünde dhe Kovács László
Šaf Ljiljana dhe Šaf Vladimir
Schleppné Dr. Kasz Edit dhe Schlepp Péter
Senk Hajnalka
Stegena Éva
Stilin Tihomir dhe Stilin Maja
Pintér Csaba dhe Szegfű Zsuzsa
Szabó Ferencné dhe Szabó Ferenc
Szabó Péter dhe
Szabóné Horváth Ilona
Szeghy Mária
Szekér Marianna
Székel János dhe Juhász Dóra
Szidiropulosz Angelika dhe Miklós
Tamás János dhe Tamás Jánosné
Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné
Dr. Tombáczné Tanács Erika dhe
Dr. Tombácz Attila
Tóth Csaba
Ugrenović Miodrag dhe
Ugrenović Olga
Virágné Tóth Erika dhe Virág Tibor
Vító László

Niveli II

Bánhegyi Zsuzsa dhe
Dr. Berezvai Sándor
Bíró Tamás
Botis Gizella dhe Botis Marius
Czele György dhe
Czeléné Gergely Zsófia
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin dhe
Dr. Seres Endre
Erdős Attila dhe Bene Írisz
Fekete Zolt dhe Ruskó Noémi
Gecse Andrea
Illyés Ilona
Janović Dragana dhe Janović Miloš
Kis-Jakab Árpád dhe
Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Nagy Gabriella
Nagy Katalin
Papp Imre dhe Péterbencze Anikó
Rózsahegy Zsoltné dhe
Rózsahegy Zsolt
Dr. Schmitz Anna dhe
Dr. Komoróczy Béla
Siklósné Dr. Révész Edit dhe
Siklós Zoltán
Tóth István dhe Zsiga Márta
Tóth Sándor dhe Vanya Edina
Varga Géza dhe
Vargáné Dr. Jurónics Ilona

Niveli III

Berkics Miklós
Bruckner András dhe
Dr. Samu Terézia
Buruš Marija dhe Buruš Boško
Éliás Tibor dhe Szász Marianne
Dr. Kósa L. Adolf
Halmi István dhe
Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt
Lomjanski Stevan dhe
Lomjanski Veronika
Dr. Ratković Marija dhe
Ratković Cvetko
Szabó József dhe Szabó Józsefné
Szépné Keszi Éva dhe Szép Mihály
Utasi István
Varga Róbert
Vágási Aranka dhe Kovács András

Të Nderuar Shpërndarës!

SUCCESS DAYS TË VITIT 2007 NË HUNGARI

13 janar, 17 shkurt, 24 mars, 26 maj, 23 qershor, 21 korrik, 15 shtator, 20 tetor, 17 nëntor, 15 dhjetor.

NJOFTIMET E QENDRËS SË RAJONIT:

Zyrat e Hungarisë:

- Zyra qendrore e Budapestit: 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel: +36-1-269-5370. Drejtori i marrëdhënjeve ndërkombëtare: Lenkey Péter.
- Magazina e Budapestit: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11., tel: +36-1-291-8995. Drejtori i rajonit: Lenkey Péter.
- Zyra e Debrecenit: 4024 Debrecen, Szent Anna u. 31., tel: +36-52-349-657. Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Zyra e Segedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., tel: +36-62-425-505. Drejtori i rajonit: Radóczy Tibor
- Zyra e Szekesfehervarit: 8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3., tel: +36-22-333-167. Drejtori i rajonit: Földi Attila

Zyrat e Bosnia-Hercegovinës:

- Zyra e Bijeljina: 76300 Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3., tel: +387-55-211-784
- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650. Drejtori i rajonit: Enra Hadžović

Zyrat e Kroacisë:

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Grada Mainza 21., tel.: +385-1-390-9770.
- Zyra e Splitit: 21000 Split, Križine 19. tel.: +385-21-459-262
Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

Zyra e Kosovës:

- Prishtinë, Rr. Zagrebi PN, tel.: +381-38-240-781.
Drejtori i rajonit: Lulzim Tytynxhiu.

Zyra e Malit të Zi:

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br: 20.
tel: +381-81/245-412, tel/fax: +381-81/245-402.
Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Zyrat e Serbisë:

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Ucutelj Tasina 13/1. tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Rade Končara 80. Tel.: +381-24-792-195
Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Zyra e Sllovenisë:

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 18., 9220 Lendava.
Drejtori i rajonit: Kepe Andrej.

E PARREGULLT:

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si **njësi të shitjes me pakicë**. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve, ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit **www.flpseeu.com**.

Porosisni produkte në faqen e internetit **www.flpseeu.com**.

Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt – jo vetëm përsa i përket blerjes së drejtpërdrejtë të produkteve, por edhe regjistrimit të prorisive. Është një mjet i shkëlqyer edhe gjatë rekomandimit të produkteve, pasi kjo ofertë është joshëse për çdo të interesuar. Vlera e pikëve të çdo porosis brenda 24 orëve i shtohet vlerës aktuale, dhe mund të lexohet në çdo moment nëpërmjet internetit (www.foreverliving.com).

Kartat plastike të blerjes me shumicë mund t'i merrni personalisht gjatë ditëve të punës në zyrat e kompanisë sonë.

Kompania jonë u ofron Distributorëve të saj një mundësi të re për të kontrolluar pikët e tyre.

– Në fund të llogarisë së bonusave tuaja që merrni çdo muaj në dorë gjeni emrin e përdorimit (LOGIN ID) dhe fjalëkalimin (PASSWORD) tuaj për të hyrë në faqen amerikane të kompanisë (www.foreverliving.com). Pas hyrjes në faqe, duke shtypur Hungarinë mund të shikoni pikët tuaja.

– Informacione rreth pikëve mund të kërkonti edhe nëpërmjet sistemit të sms-ve që funksionon me sukses prej vitesh.

– Edhe punonjësit e shërbimit telefonik të zyrës sonë qendrore të Budapestit ju informojnë rreth pikëve tuaja aktuale të qarkullimit. **Vlerat e pikëve të tyre personale** distributorët e Budapestit mund t'i pyesin në numrin e telefonit +36-1-269-53-70 dhe +36-1-269-53-71, kurse të Kroacisë, Bosnia-Hercegovinës, Sllovenisë, Serbisë dhe Malit të Zi +36-1-322-55-41. Ju lutemi bashkëpunonjësve tanë të interesohen vetë për pikët dhe biznesin e tyre personal!

Informacione nga interneti:

Njoftojmë shpërndarësit tanë të dashur se mund të marrin informacione nga dy faqe interneti të kompanisë sonë. Njëra faqe interneti "www.flpseeu.com" është faqja kompanisë së vendit tonë, nëpërmjet të cilës mund të arrihen magazinat e vendit tonë. Kodet për të hyrë në këtë faqe dhe për të bërë blerje mund t'i kërkonti në zyrat tona. Faqja kryesore e internetit të kompanisë, apo siç quhet zakonisht "faqja amerikane" "www.foreverliving.com" përmban informacione rreth lajmeve nga FLP-ja, kontaktimeve ndërkombëtare, si dhe rezultateve të pikëve ditore të punonjësve. Në këtë adresë mund të hyjnë gjithë të interesuarit. Në faqen e distributorit mund të

hyni duke klikuar mbi "distributor login". Emri i përdoruesit është numri juaj i distributorit (pa shenjat e ndarjes). Fjalëkalimi gjendet në fund të llogarisë suaj mujore.

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që në të ardhmen ti kushtojnë kujdes plotësimi të saktë të **porosive të produkteve dhe të formularëve të tjerë!** Porositë e produkteve të korrigjuara (emri i porositisë) dhe të panënshkruara, me qëllimin për të shmangur gabimet, nuk mund ti pranojmë. Ju lutemi gjithashtu, të kujdeseni për plotësimin e saktë dhe të lexueshëm të formularëve të regjistrimit: me shkronja shtypi, me bojë të zezë ose blu. Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit, ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave! **Iu njoftojmë që nënshkrimi dhe dorëzimi pa autorizim i kontratave është i parregullt, prandaj për falcifikim dokumentash do t'ua përcjellim autoriteteve përkatëse.**

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e **paraqitjes së bonuseve** nëpërmjet të besuarit për këtë, ky person i besuar të sjell me vete edhe letërnjoftimin e tij! Sipas politikës ndërkombëtare të biznesit, çdo shpërndarës, që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice, direkt nga zyrat. Gjithashtu, shpërndarës i regjistruar, ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur kopjen e dytë të formularit të regjistrimit së plotësuar më parë dhe dokumentin e porosisë së produktit të plotësuar.

RISPONSORIZIMI!

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për rregullat e "risponsorizimit" të cilat gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është se risponsorizimi s'është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimit të formularëve të përcaktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe përgjigjes së kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që bashkëpunonjësit distributor të regjistruar njëherë i fut për herë të dytë pa plotësuar procesin e risponsorizimit.

NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË:

Njoftojmë Shpërndarësit tanë të nderuar se vendi i organizimit të Success Day Forever të 13 janarit 2007, që fillon në orën 10, është: Arena Sportive e Budapestit, Budapest, 1143, Stefánia út 2. I mirëpresim të gjithë! Dëshiroj t'iu njoftoj përsëri se magazina jonë në rrugën Nefelejcs është hapur në orarin 17-20. Orari i hapjes gjatë festave është: 2, 9, 16, 23, 30. - çdo të shtunë sipas orarit të hapjes javore. **Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.**

Magazina e FLP-s, Budapest

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt.



Zyra e Debreceinit

Numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës mujore mund të lexohen në faqen tonë të internetit duke përdorur passwordin „forever”.

Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje

Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

1/Deklarata: Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.

2/Blerja: Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësojnë deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto



gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3/Informimi: Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributort tanë të Nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakojat merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:

– në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit.

Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149

– nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,

– me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Çmimet e transportit:

	Budapest	Provincë
0-5 kg	640 Ft	1260 Ft
5-10 kg	1240 Ft	1720 Ft
10-30 kg	1520 Ft	1940 Ft
Mbi 30 kg	30 Ft/kg	30 Ft/kg

- Çmimet e mësipërme janë të vlefshme deri në 3 porosi/adresë, mbi 3 porosi llogaritim +200 Ft/porosi.

- Çmimi i postimit është 360 Ft/adresë.

- Siguracioni: deri në shumën 200 000 Ft e përmban çmimi i transportit, mbi këtë shumë për çdo 10 000 Ft është 50 Ft.

Çmimet e mësipërme nuk përmbajnë TVSH-në prej 20%.

Transportimi i porosisë bëhet pas përputhjes paraprake në telefon.

Shpenzimet e përputhjes në telefon përmbahen nga çmimet e mësipërme.

NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBIË:

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosisë në telefon - telecenter. Të gjitha mallat mund ti porosisni në numrin e telefonit: 011/309-6382. Orari i punës së Telecenterit dhe zyrës së Beogradit: të martën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit. Malli paguhet gjatë marrjes së tij.

Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi. Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit. Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave. Success Day Forever e ardhshme do të mbahet më 23 dhjetor 2006.

NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS:

Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias, porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit):

Bijelina: +387-55-211-784. Orari i hapjes në ditët e punës: 9:00-16:30



Zyra e Bijelinës

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

Njoftojmë konsumatorët dhe punonjësit tanë të nderuar se adresa e zyrës së Sarajevës është: Akifa Šeremeta do br. 10, 71000 Sarajevo
Sarajevo: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651
Orari i hapjes: 9:00 – 16:30, çdo të mërkurë: 12:00 – 20:00

Njoftojmë konsumatorët dhe punonjësit tanë të dashur se nga shtatori në shërbimin tonë është kështilltarja dhe specialistja mjeke nga Bosnia-Hercegovina **Dr. Esma Nisic**, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00. Kështilltarja dhe specialistja jonë mjeke çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:00.

Të mërkurën: 12.00-20.00 Në rastin e porosisë telefonike, pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë nuk e kalon vlerën e një pike, atëherë transportimin në shtëpi e paguan shpërndarësi.

Adresa e re e zyrës së Bijeljinës:

FLP-Bos Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3, 76300 Bijeljina. Tel: 055/211-784, 055/212-605, fax: 055/221-780.

Adresa e qendrës së Banja Lukës:

Duško Koščica u. 22. Tel: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288

NJOFTIMET E ZYRËS SË KROACISË:

Njoftojmë konsumatorët dhe distributorët tanë se zyra e FLP-s së Zagrebit gjendet në adresën Grada Mainza 21. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Tel.: +385-1-3909-770 dhe fax.: +385-1-3909-771. Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja. Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore. Ju njoftojmë mëtej se zyra jonë e Splitit gjendet në adresën Križine 19. Tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00.

NJOFTIMET E ZYRËS SË SLOVENISË:

Ju njoftojmë se orari i hapjes së magazinës sonë në Trzin është: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Ky orar hapje është i vlefshëm edhe në rastin e porosive telefonike. Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Adresa e magazinës së Lendvai-t: Kolodvorska 18, 9220 Lendva
Tel.: +386-40-955-167.



Zyra e Lendvait

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426
Dr. György Bakaneck: +36-20-944-1442
Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442
Dr. László Mezösi: +36-20-552-6792.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070

Szertbiai orvos szakértőink telefonszáma:

Dr. Biserka Lazarević és Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788
Dr. Canzek Olga: +386-41824163

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127

FLP TV

Në internet

www.flpseeu.com

PROGRAMI

15. 12. 2006–13. 01. 2007.

- 10.00 **Lajme**
- 10.05 **FLP-ja prej 25 vitesh**
- 10.20 **Rex Alex – Qendra disenjo Aloe**
- 11.50 **Rally European 2006 – Kanë, Niza**
- 12.00 **Success Day – Miklos Berkics - Dhuratë**
- 12.30 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 12.40 **Success Day – Kim Madsen**
- 13.30 **Film prezantues produktesh – Aktiv Probiotik**
- 13.40 **FLP – Plani Marketing**
- 14.00 **Success Day – Sonya Show**
- 14.20 **Success Day – Patricia Rusak– Guxo të ëndërrosh gjëra të mëdha!**
- 14.40 **Intervistë me Aranka Vagasi-n dhe Andras Kovacs-in**
- 15.05 **Film prezantues produktesh – Active HA**
- 15.10 **Alan Pease – Teknika e të pyeturit**
- 16.25 **Nga bima deri tek produkti**
- 16.40 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 16.45 **Success Day – Jozsef Szabo– Ruaji ëndrrat e tua**
- 17.05 **Katrin Bajri – Në majë me sistemin**
- 18.00 **Lajme**
- 18.05 **FLP-ja prej 25 vitesh**
- 18.20 **Rex Alex – Qendra disenjo Aloe**
- 18.50 **Rally European 2006 – Kanë, Niza**
- 20.00 **Success Day – Miklos Berkics - Dhuratë**
- 20.30 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 20.40 **Success Day – Kim Madsen**
- 21.30 **Film prezantues produktesh – Aktiv Probiotik**
- 21.40 **FLP – Plani Marketing**
- 22.00 **Success Day – Sonya Show**
- 22.20 **Success Day – Patricia Rusak– Guxo të ëndërrosh gjëra të mëdha!**
- 22.40 **Intervistë me Aranka Vagasi-n dhe Andras Kovacs-in**
- 23.05 **Film prezantues produktesh – Active HA**
- 23.10 **Alan Pease – Teknika e të pyeturit**
- 00.25 **Nga bima deri tek produkti**
- 00.40 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 00.45 **Success Day – Jozsef Szabo– Ruaji ëndrrat e tua**
- 01.05 **Katrin Bajri – Në majë me sistemin**
- 02.00 **Lajme**
- 02.05 **FLP-ja prej 25 vitesh**
- 02.20 **Rex Alex – Qendra disenjo Aloe**
- 02.50 **Rally European 2006 – Kanë, Niza**
- 04.00 **Success Day – Miklos Berkics - Dhuratë**
- 04.30 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 04.40 **Success Day – Kim Madsen**
- 05.30 **Film prezantues produktesh – Aktiv Probiotik**
- 05.40 **FLP – Plani Marketing**
- 06.00 **Success Day – Sonya Show**
- 06.20 **Success Day – Patricia Rusak– Guxo të ëndërrosh gjëra të mëdha!**
- 06.40 **Intervistë me Aranka Vagasi-n dhe Andras Kovacs-in**
- 07.05 **Film prezantues produktesh – Active HA**
- 07.10 **Alan Pease – Teknika e të pyeturit**
- 08.25 **Nga bima deri tek produkti**
- 08.40 **Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen**
- 08.45 **Success Day – Jozsef Szabo– Ruaji ëndrrat e tua**
- 09.05 **Katrin Bajri – Në majë me sistemin**

**MARIANNE SZASZ**

soaring manager
anëtare e President's Club

"T'i japim gjithçkaje atë që meriton. Syrit pamjen, veshit muzikën, mendimeve fluturimin, trupit freskinë, të vërtetës vlerësim, shokut shokun, njeriut respektin."

(Tatiosz: Virtytet e zemrës)

Një hungarez në

U zgjova në një mëngjes të shkëlqyer. Pas disa minutash në ajër u ndje aroma e kafesë. I mbusha edhe "teket" e pashmangshme që me këtë të zgjoja edhe Tibor-in. (Kokteili xhel-Pomesteen është i domosdoshëm për fillimin e mbarë të ditës) Por ai u ul përpara kompjuterit dhe më pa me dyshim:

— Eja, lexoje! Mirë po e shikoj?

Letra e hapur — megjithëse shkruhej anglisht — ishte e qartë edhe për mua. "Houston, Super Rally, You singing" dhe datë... nënshkrim. Gregg Maughan.

I emocionuar dhe plot me ndjenja të përziera pashë marrësin e letrës. Mezi formova pyetjen:

— Si ka mundësi kjo? Nga e dinë... nga e dinë se je i aftë të këndosh në mënyrë të denjë për në skenën e Super Rally-t?

— Përpara disa vitesh, kur Rex-i ishte këtu, unë e udhëhoqa në Dunakanyar. Kaluam së bashku një ditë të tërë. Atëherë u binda që çfarë personi fantastik është ai. Që nuk është legjendë, por njeri i zakonshëm prej mishi e gjaku, dhe i cili mbeti i tillë pavarësisht nga gjithë pasuria e tij.

Me të vërtetë! M'u kujtua dita e Profit Sharing në Bukuresht. Në mbrëmje pas darkës në Parlament u ula në shkallët e pallatit për të pritur Tibor-in i cili e ka zakon të më humbas. Zura daljen. Këtu me siguri më gjen ose e shikoj nëse del — mendova.

Ndërkohë në pallat hyri Rex Maughan.

Pas disa hapash më vuri re që po ngjethesha në shkallë dhe u nis drejt meje. Më zgjati dorën, më ndihmoi të ngrihem dhe më pyeti me dashamirësi: — Ke ndonjë problem Marianne? (Mezi morra frymë. Dhjetë muaj më parë u takuam në Kopenhagë. Shkëmbeu disa fjalë me Tibor-in i cili na prezantoi me njëri-tjetrin. Dhe e mbante mend emrin tim. Por në një Rally takohet dhe del në fotografi me mijëra njerëz.) — Faleminderit, çdo gjë në rregull — iu përgjigja.

Më përqafoi këndshëm dhe duke më uruar natën e mirë u largua.

Tibor-i vazhdoi:

— Kjo ditë ishte aq e mrekullueshme sa që si falenderim i dhurova një CD me këngët napolitane që këndoj unë. Por me thënë të drejtën nuk mendova se do t'i dëgjonte ndonjëherë. E imagjinon se sa gjëra i dhurojnë nga çdo vend i botës...

— Sipas kësaj e ka dëgjuar...

— Kështu duket. Çfarë nderi! E imagjinon dot? Aty përfaqësohen njëqind e njëzet shtete nga bota jo me një numër të vogël njerëzish!

— Çfarë dëshiron të këndosh? — i bëra pyetjen praktike.

— Diçka të madhe, ndonjë këngë fitoreje... Nuk e di. Çfarë mendon?

Pasi u mendova pak thashë një nga ariat tenore më të vështira në botë. Sfidë e madhe — mendova — por mund ta zgjidhë në mënyrë brilante. Është gjithmonë i aftë të ngrihet në lartësinë e detyrës. Nëse ka pikësynim, ka edhe rezultat!

skenën e Super Rally-t

— Aria e Kalafit. “Vincero-n!”
— E di se çfarë detyre është kjo?
— E di, por po të duash e zgjidh edhe detyrën më të vështirë!

Dhe atëherë nuk e dija akoma se na pret një sfidë shumëherë më e madhe se sa aria! Siguruam bazat muzikore, më të mirat që mund të sigurohen në vendin tonë të vogël, dhe Tibor-i praktikonte dhe bënte prova, pasi edhe zëri oksidohet kur nuk përdoret ditë për ditë. Duhet ndriçuar, duhen larguar depozitimet nga kordat e zërit. E dërguam përgjigjen, ku shkruam se do të dëgjojnë “Kalafin”. Po afrohej dita e udhëtimit, zëri shkëlqente, teksti ecte pa gabim, artisti kishte emocionet e duhura, pra gjithçka ishte ashtu siç duhej! Kishin mbetur vetëm disa ditë deri në udhëtim, kur shpërtheu bomba! Kërkesa modeste e Rex Maughan-it: Po të ketë mundësi, do të dëgjonte më me dëshirë këngën e njohur të Fantomit të Teatrit, Nata si kadife! Me siguri as nuk e imagjinonte se kjo nuk bënte pjesë në repertorin e Tibor-it. Dhe nuk bënte pjesë. As shfaqjen nuk e kishte parë.

A mund ta shikosh dhe ta mësosh brenda kaq kohe, a mund të gjesh bazën e duhur muzikore, a ia vlen ta marrësh përsipër pa zotëruar njohuritë e duhura? Mijëra pyetje! Do të ketë mundësi prove? Si do të jetë mikrofonit?

Dhe filloi një ngutje e madhe. Të sigurojmë gjithçka: bileta për në “fantom” (kishim fat sepse po luanin shfaqjen e fundit të sezonit), bazën muzikore — dhe siguruam dy variante

— të gjesh mësues me kohë të lirë, tekst që i përshtatet muzikës. . . dhe gjithë këtë ta mësosh brenda disa ditësh.

Fati ishte me ne. Çdo gjë u bë bashkë, kënga me “vincero”, dhe nuk do të ketë problem nëse arrin të mësoj edhe tekstin në anglisht. . .

Morrëm me vete MP3 dhe tekst të shkruar, Zsolt Fekete në fillim të rrugës e përktheu tekstin që duhej mësuar, dhe dhjetë orët në aeroplan, kohën e pritjen në aeroport dhe kohën e qëndrimit në hotel ia kushtuam kësaj. Natyrisht në fund të valixhes ndodhej edhe CD-ja që menduam në fillim. Si do që të ndodhë!

Pastaj morrëm vesh se kemi njëzet minuta kohë prove në pallat. Në pushimin e drekës. Personeli i teknikës nuk na shërbeu me ndonjë dëshirë të madhe. Mikrofon fyti “natyrisht” që s’kishte, kurse pretekste plot.

Por këto ishin kushtet! Më dolët lot nga emocionet. . . Pastaj u dëgjua muzika, akordet e para dhe zëri lirik i Tibor-it. . . Punëtorët që deri në atë moment po bënin zhurmë dhe po bisedonin, pushuan. Tekniku i zërit ndaloi muzikën, kërkoi falje dhe doli jashtë. Pas disa minutash u kthye me një mikrofon fyti të shkëlqyer. Tha se ai kishte punuar për shumë vite si teknik zëri në operën e Los Angeles-it, dhe nuk kishte shpresa të mëdha tek artisti “amator”. I vjen keq për këtë, por ky zë e meriton mikrofonin e mirë dhe vëmendjen.

Të nesërmen kishte edhe ekran teksti, dhe skuadra e teknikës nga antitifoiz u bë sfond mbështetës!

Respekti i rezultatit! Kur flasim për këtë në aktivitetet tona, kujtojmë se flasim për MLM-n apo për FLP-n. Por ne flasim për JETËN. Dhe mund ta them me kënaqësi se: FLP-ja flet për JETËN! E ke vënë re?





TEREZIA SZASZKO
supervisore

Në ditën e fundit të korrikut të 2006-ës filloi periudha ime e FLP-s, për të cilën kisha dëgjuar shumë nga të tjerët. Duke i bërë një analizë, ky është një kapitull i ri në jetën time.



Holiday Rally me

34 ditët e mia të para ishin një periudhë dinamike, plot informacione e njerëz të rinj. Rezultati i kësaj ishte jo vetëm ajo që më takonte nga puna e bërë, por edhe ajo që morra falas, si shpërblim, një udhëtim për në Kroaci nga **29 shtatori deri më 1 tetor** shpenzimet e të cilit siguroheshin **plotësisht nga FLP-ja.**

As në jetën time dhe as në rrethin e të njohurve të mi nuk kisha parë që një punëdhënës t'u japë një premium të tillë punonjësve të rinj.

Natyrisht këtë mundësi e përfitova falë punës së madhe dhe aktive të gardës së vogël që u formua rreth meje, si dhe sponsorit tim, **Laszlo Hajdu.**

Që në fillim ndjeva kujdesin dhe punën e madhe që karakterizonte gjithë udhëtimin. Autobus modern dhe i rehatshëm. Ushqimi: mëngjes + drekë (si në aeroplan) ishte cilësor, i shijshëm dhe elegant.

Ecuria e karvanit prej tre autobusash garantohej nga makina dhe njerëz të caktuar. Kur mbërritëm na pritën me dhurata plus, çanta dhe bluza me simbolin e kompanisë sonë. Hoteli ishte me nivel të lartë dhe morrëm shërbim të shkëlqyer gjatë qëndrimit tonë aty. Si shplohje në mbrëmje të deleguarit u argëtuan në disko me hyrje dhe



sy rin e supervisorit të ri

pije falas, ku ata morrën pjesë në mënyrë aktive.

Në ditën kryesore të aktivitetit edhe radha e të ulurit tregoi se supervisorët që kishin plotësuar kushtet e programit me karta akreditimi zunë vendin kryesor në sallën e leksioneve. Drejtori ynë gjeneral, **Dr. Sandor Milesz**, me dhënien e fletëlavdërimeve i përgëzoi përsëri ata që kishin arritur këtë nivel.

Ishte tepër frymëzuese të dëgjoje përsëri lektorët e njohur mirë nga kasetat, CD-t dhe programet e mëparshme. I riu me vlera shembullore njerëzore, **Miklos Berkics**, e kishte zgjidhur bukur me një orë me zile që mos ta tejkalonte dhe ta shfrytëzonte siç duhet kohën që kishte në zotërim. Për herë të parë ndjeva energji dhe vullqaz të madh, të cilën na e dha **Jozsef Szabo** dhe të cilin nuk e merrnim dot as në fotografi sepse dilte gjithmonë jashtë ekranit. Temperamenti udhëheqës i



Veronika Lomjanski-t më bëri për vete, kurse modestia dhe vullneti i fortë i **Katrin Bajri**-t na tregoi se kemi akoma për të mësuar.

Isim pjesëtarë të një "rënie yjesh-shfaqje gurësh të çmuar" të vërtetë.

Edhe gjatë mëngjesit të ditës së fundit dëgjuam fjali

entuziazmuese dhe udhëzuese nga drejtuesit tanë të lartë, **Aranka Vagasi** dhe **Andras Kovacs**, kështu që të mbushur plot me forca u nisëm për në shtëpi, për t'u përgatitur drejt pikësnyimit të ardhshëm, Rally-t European të Stockholmit, ku shpresoj të takohem për herë të parë me **Rex Maughan**-in, me të cilën do të nis një traditë të re.





ANGELIKA SZIDIROPULOSZ
(Evi Görög)
managere

Shkëlqen dielli dhe bashkë me të edhe unë! Pothuasje fluturoj nga kënaqësia dhe lumturia që punoj në një kompani ku më respektojnë, më duan mua dhe suksesin tim! Prandaj po e shkruaj këtë letër që të falenderoj nga larg njerëzit e mrekullueshëm të cilët e ndihmojnë skuadrën time me fjalë të mira, i japin besim me zemër të pastër edhe kur s'kanë interesa materiale.



Mirëdita Hungari!

"Toronto" paraqitet!

Mendoj se kjo quhet skuadër e madhe, familje. Familja FLP! E di që fillestarët mendojnë se këto janë vetëm fjalë, por më besoni se sa më gjatë qëndron në biznes, aq më shumë e kupton se përse po flas. Pra, vetëm bëje! Asnjëherë mos hiq dorë!

Këtu dëshiroj **të falenderoj** në radhë të parë **sponsoren time, Annamaria Bernath**, për durimin dhe punën këmbëngulëse, si dhe dashamirësinë që tregoi ndaj meje, për mbështetjen dhe ndihmën e saj për ta mbajtur të bashkuar gjithë linjën tonë edhe pas arritjes së nivelit të managerit. Kjo është si një martesë, apo jo **Annamari**? Në të mirë e në të keqe, dhe ndonjëherë sido që duan të tjerët, nuk mund ta ndajnë dot familjen! **FALEMINDERIT ANNAMARIA!**

Falenderoj **Nikos**-in, partnerin, shokun, bashkëshortin tim prej 33 vitesh që e pranoi vendimin tim dhe më siguroi sfondin e duhur! Tani po festojmë përvjetorin e 5-të me Forever-in, dhe ky është një përvjetor i rëndësishëm!

Jam shumë krenare për gjithë skuadrën time, për **Bea Tasnady**-n dhe **Zoli Vörös**-in, iu falenderoj për punën tuaj, për besimin që patët tek unë dhe për këmbënguljen tuaj fantastike. Falenderoj **Laci Kotai**-n dhe **Tibi**

Fekete-n, të cilët ecin përpara me këmbëngulje dhe sado që takohen me kafshata të mëdha, qëndrojnë prapë aty. Falenderoj **Zoli** dhe **Pepe Barabas**-in për ndihmën që i dhanë skuadrës! Jeni në gjendje ta bëni! Kjo është familja jonë e vogël! Ti çfarë "Familje" ke? Jam i sigurt se ndodhesh në vendin më të mirë! Po iu them sekretin: asnjëherë mos hiq dorë! Falendero njeriun që ta tregoi dhe të shtrëngoi dorën. Varet nga ty që e lëshon apo jo!

Jemi gjithashtu tepër krenarë për managerët tanë, **Dr. Erika Tanacs Tombaczne** dhe **Dr. Attila Tombacz, Irenke** dhe **Feri Tanacs**, të cilët ndoqën Bea-n dhe e ndërtuan biznesin e tyre me një shpejtësi fantastike (është e vërtetë se ndonjëherë balona e fryrë çahet, por e jona qëndron vazhdimisht lart), dhe e rëndësishme është që edhe sot, me 80 cc pikë non manageri, nuk e kanë mbyllur akoma (e kupton ti këtë?), dhe e përfaqësuan skuadrën tonë në Rally-n European, me të cilën treguan se si radhën tjetër të udhëtojmë edhe më shumë së bashku. Falenderoj **Mariann Szeker**-in dhe **Kata Ungar**-in që u morrën me managerët tanë në Rally-n European në Francë.

Përgëzoj edhe assistant managerët, **Brigi** dhe **Balazs Bicskei**-n, **Aranka Mezei**-n, supervisorët, **Evi Mentés**-in që ndihmon fëmijët,

Gabi Koncz-in dhe **Zoli Rabi**-n. Përgëzojmë **Andi Koncz**-in për rezultatet e saj dhe gëzohem që kur isha në shtëpi gjeta një diamant të humbur, në të vërtetë në tokën e një tjetri, dhe fillova ta lustroja dhe ta nxirrja nga dheu. Shpresoj që këtë pronarët e këtij diamanti do ta vlerësojnë këtë njeësi me zemër kaq të madhe dhe do të kujdesen për të! Mbushem me kënaqësi kur mendoj se sa të ndershëm, këmbëngulës dhe të mrekullueshëm janë këta njerëz, të cilët me fëmijë në krahë, por prapë e bënë dhe ecën me shpejtësi drejt majës, sjellje dhe qëndrim shembullor kudo që takohesh me ta. Nëse edhe Ti je i mrekullueshëm, atëherë edhe Ti mund ta bësh!

Falenderoj **Zoli Vörös**-in dhe **Dr. Attila Tombacz**-in, dhe natyrisht të gjithë djemtë për punën e tyre të madhe që kur mungojnë vajzat, janë Ata që kujdesen për fëmijët. "Punë skuadre, e kupton", siç e thotë **Jozsi Szabo**.

Natyrisht duhet të përmend edhe skuadrën e Torontos, **Agi Kiss**-in e cila është tepër këmbëngulëse, dhe s'ka rëndësi se çfarë duhet të bëj, e bën. Faleminderit që ke besim tek unë **Agi**. Jemi të sigurt që do ta bësh edhe ti!

Këtej nga larg dëshiroj të përgëzoj **Tibi Radoczki**-n për sukseset e reja, dhe iu falenderoj shumë që ndihmoni punën e skuadrës sonë të Szegedit. Falenderoj **Dr. Sandor Miliesz**-in, drejtuesin kryesor të skuadrës sonë, është diçka fantastike mënyra se si i qëndrojnë pranë njëri-tjetrit. Kjo quhet Familja FLP. Faleminderit për dashamirësinë dhe njohuritë që morra nga Ju, **Tibor**!

Falenderoj mjekët tanë, **Dr. Marcsi Botos**, **Dr. Editke Revesz**, **Dr. Endre**

Nemeth, Dr. Kerekes, Dr. Elemer Nagy, për punën e tyre dhe ndihmën që i dhanë skuadrës sonë.

Përgëzoj edhe **Peter** dhe **Zsuzsi Lenkey**-n për punën dhe leksionet e tyre, jeni njerëz me zemër të pastër, të përlur, modest dhe me njohuri të madhe! Kjo vetëm kështu mund të bëhet! Një shembull i ri përpara nesh! E kuptoni?!

Me respekt të madh dëshiroj të falenderoj hapur **Miki Berkics**-in për punën e tij dhe CD-t që më dërgoi, të cilat ishin një ndihmë e madhe për mua, dhe të falenderoj që e mbajte premtimin. E kupton? **Miki** s'ka ndonjë interes material me ne, por prapë na ndihmon! Edhe në anën tjetër të botës! S'është rastësi që ai ka managerë si **Mariann Szeker**-i.

Faleminderit **Ibolya Csaszar** për fjalët e tua të dashura që i the skuadrës sime në Szeged, për mirësinë dhe ndershmërinë tënde, skuadra ime mendon me dashamirësi të madhe për Ty!

FALEMINDERIT REX MAUGHAN për mundësinë, faleminderit për mënyrën tënde të të menduarit, për mësimin, ndershmërinë, mirësinë, jetën tënde familjare shembullore, faleminderit që na mëson të ecim me modesti në këtë tokë dhe ta dimë se nga kemi ardhur. Më mbeti në mendje kur në Rally-n European të Hungarisë Rex-i tha: "Je njeri me të vërtetë i madh nëse mund të përulësh dhe mund ta ngresh atë njeri në nivelin ku Ti je! Jepi njeriut mundësinë për t'u bërë aq sa vlen!" Ky është arti. Mundësi jo e zakonshme e njerëzve të zakonshëm.

Falenderoj jo në radhë të fundit drejtorin tonë gjeneral, **Dr.**

Sandor Miliesz, për punën e tij këmbëngulëse dhe krenohemi që mund të punojmë me një drejtues të tillë dhe mund ta themi kudo me krenari emrin e tij, pasi s'ka njeri që nuk e njeh dhe nuk e do! **FALEMINDERIT SANDOR**, je shembull i shkollës së lartë të mënyrës së sjelljes në biznes dhe me njerëzit!

Faleminderit **Dr. Adolf L. Kosa** dhe **Tamas Biro** që ma treguat këtë mundësi!

Shpresoj se njëherë do të jeni me të vërtetë krenar për këtë skuadër, e vërtetë që s'jemi formula uno, por gjithmonë fiton ai që mbetet në garë! Rezultatet flasin vetë! **Dr. Kosa** është një makineri që nuk mund të arrihet, dhe na jep vazhdimisht ritëm të ri! **FALEMINDERIT Adolf!**

Toronto është një qytet shumë i madh ku jetojnë së bashku kombësi të ndryshme. Por edhe këtu mund të bëhet, pavarësisht se ndonjëherë rruga është me pengesa, duke menduar se një shtet i vogël si Hungaria është në vend të tretë! E kupton? Shumë njerëz iu ndjekin me vëmendje dhe përpiqen të ecin në gjurmët tuaja. Shpresoj se kjo do të thotë diçka për të gjithë! Mbushemi me krenari! Prandaj duhet të kemi shumë kujdes, kudo që shkojmë, brenda apo jashtë vendit, me skuadrën apo vetëm, duhet të jemi shembull në çdo aspekt në mënyrë që ta meritojmë respektin e të tjerëve. Falë Zotit, në skuadrën hungareze ka njerëz të mrekullueshëm. Faleminderit që jeni!

Më mungon shumë buzëqeshja dhe dashamirësia juaj, dhe ndihem mirë kur mendoj për ju. Përpara Hungari! Ju dua shumë!

TË FESTOJMË

Po afrohen Festat, por të qëndrojmë pak për në moment! Pasi Krishtlindjet nuk bëjnë fjalë vetëm për dhuratat dhe menunë speciale, por do të ketë raste të shumta kur do të marrim pjesë në darka, parti dhe aktivitete të tjera.



Burimi: Let's party with Sonya
In: Forever UK. November 2006/issue 165, pp. 20-21

Natyrisht që dëshira jonë është të dukemi sa më mirë, për të mos përmendur se sa raste të shkëlqyera do të na jepen për rekomandim produktesh dhe ndërtim rrjeti! Paraqitja jonë e jashtme që shpërthen nga shëndeti dhe rrezaton nga bukuria do t'i tërheqë lehtë të interesuarit e shumë. Nuk mund ta përfaqësojmë biznesin tonë në mënyrë më të besueshme se kur e përdorim edhe vetë.

Paleta e Sonya Colour Collection është e shumëanëshme. Zgjedhje e veçantë dhe karakteristika të veçanta:

- Përmban Aloe Vera, materiale deti dhe kamomil me efekt qetësues
- Vaji i avokados hidraton dhe zbut buzët
- E ushqen dhe e mbron lëkurën tonë pa i bllokuar porët
- Përmban vitaminat antioksidante A, C dhe E që të na mbrojnë kundër efekteve dëmtuese të oksidantëve
- Lëndët ngjyruese në harmoni me ekuilibrin kimik të lëkurës mund të përdoren duke siguruar një efekt natyror
- Përmbajtja e aloe vera-s e produkteve tona dhe efektet e saj 15 faktorësh mbrojtëse të lëkurës mbrojnë kundër rrezeve të dëmshme të diellit
- Produktet tona në formë pluhuri, pudrat, ngjyrat e syve dhe skuqësit e fytyrës përgatiten me procedurën më të imët të mikronizimit, kështu që nuk mund të bëhen kokrra, të mblidhen në rrudha apo të fshihen, me ndihmën e tyre mund të përgatishim makijazhe profesionale me efekt të gjatë.
- Produkte hypoalergjen
- Nuk kryejmë eksperimente me kafshë

Disa këshilla me të cilat çdo moshë mund të ketë sukses:

E rëndësishme është të dimë se çdo makijazh kërkon parapërgatitje të kujdesshme. T'i shmangim efektet jonatyrore nëpërmjet trajtimit të lëkurës që makijazhi të mos e mbulojë fytyrën tonë vetëm si një maskë.

Kompleti Fleur de Jouvence është tepër i përshtatshëm për këtë qëllim. Për shkak të përmbajtjes së lartë të aloe vera-s mund të përdoret për çdo lloj lëkure, pasi aloe vera ka të njëjtin efekt në lëkurën e thatë, të yndyrshme, të përzierë, të re e të pjekur.

Pastrojeni, tonizojeni dhe hidratoheni lëkurën tuaj, këto janë veprimet bazë gjatë trajtimit të përditshëm të lëkurës.

Si hap të parë të përgatitjes së makijazhit zgjidhni grimin me ngjyrën që i afrohet më shumë lëkurës suaj, pastaj fiksojeni atë me pudër.

Duke përdorur paletën **Night on the Town** tani pason një makijazh me të vërtetë tërheqës.

Sytë: *grim:* 149 Moonlight në gjithë qepallën e syrit, *cepi i syrit:* 145 Sterling, *vijzimi:* 174 Midnight Black në rrëzë të qerpikëve, *pamje tërheqës:* 155 Charcoal me një lëvizje të lehtë për nga jashtë 170 Midnight Black me spiral qerpikësh

Qepallat: 155 me krehjen e qimeve

Buzët: kontur buzësh 173 Mahogany, pastaj buzëkuq Porsche Red. Sasinë e tepërt e heqim duke puthur një shami dore, pastaj i japim shkëlqim me Aloe Lips.

ME SONYËN!

Tani të shohim se si mund të kemi një pamje ëndërruese: T'i ngjyrosim sytë me 148 Crystal Water deri tek cepi i syrit. Buzët të mos i lyejmë me buzëkuq që bie në sy, në mënyrë që të mos e heq vëmendjen nga sytë. Në lëkurën me ton të nxehtë është i favorshëm përdorimi i ngjyrave Sonya të nxehta

Sytë: *grimi:* 133 Ginger, *cepi i syrit:* 134 Mink, *theksi:* 149 Moonlight nën vijën e qepallave, e vizojmë syrin me laps 176 Burnished Brown me vijë që vjen duke u trashur në drejtim të cepit të jashtëm 170, Midnight Black me spiral qerpikësh

Gepallat: i krehim me 172 Brow Fix

Buzët: laps konturi 175 Cocoa, buzëkuq 118 Coffee Cream, pastaj përsëri laps konturi

Fytyra: 157 Sienna nën kockën e fytyrës, pastaj theksojmë kockën e fytyrës me

ngjyrën e syve 153 Sunfire, nga kjo vendosim pak edhe në buzë

Një këshillë e mirë për femrat me lëkurë të pjekur, pavarësisht se bëhet fjalë për makijazh të përditshëm apo rasti, sa më pak aq më mirë! Ta shmangim mbitheksimin në zonën e syve, këtu të mos përdorim ngjyra që shkëlqejnë, sepse këto përforcojnë rrudhat, njëlloj si pudra e shumë. Këshilloj që grimin ta vendosni në fytyrë duke e përzierë me 1-2 pika Alpha-E Factorral, nga kjo lëkura shkëlqen lehtë.

Nëse duam të theksojmë buzët, të përdorim ngjyrën 124 Dusty Rose. Mund të arrijmë efekt të mrekullueshëm edhe duke vendosur konturin e buzëve 177 Mystique me një aplikator me sfungjer në fund.

Spirali i qerpikëve kaf/i zi 171 Brown/Black na e gjallëron shikimin, kurse qepallat t'i trajtojmë me 172 Brow Fix.

Për emocione të veçanta të përdorim variantet e mëposhtme:

- Azure Blue nga 204 Sedona Trio
- 150 Pot of Gold dhe 153 Sunfire në sy, buzëkuq 128 Solid Gold dhe për shkëlqim buzësh 190 Crystal Clear 180 Golden Shimmer
- 145 Sterling dhe 152 Hologram, do të shkëlqeni!

Gjatë rekomandimit përdorni edhe broshurën tonë Sonya Colour!

Ju urojmë kënaqësi të plotë gjatë provave, ndërkohë që mos harroni të përgatisni paket e dhuratave!



A stylized yellow eagle with spread wings perched on a green branch. The eagle is facing right, with its wings fully extended upwards and outwards. The feathers are depicted with simple black outlines and yellow fill. The branch is a simple green curve. The background is white.

Pako dhuratash ***komplet/e***
ndarëshme: Berry Nectar, Aloe
Blossom Herbal Tea, Absorbent-C,
Forever Kids, Aloe First, Aloe Liquid
Soap, Propolis Creme.



QENDRA MËSIMORE DHE E SHËRBIMIT SONYA FOREVER LIVING PRODUCTS HUNGARI SHPK

Orari i hapjes në **Magazinën** tonë (1183 Budapest, rr. Nefelejcs 9–11) **e hënë, e martë, e enjte:** 14:00–20:00,
në **Qendrën** tonë (1067 Budapest, rr. Szondi 34, kati II) **e mërkurë, e premte:** 13:00– 17:00.

Ju mund të paraqiteni tek Szilvia Sztanyo në numrin e telefonit 06-1-2918991/119 ose 20/2034502, dhe tek
Magdolna Darvas në numrin e telefonit 06-1-2695370/124 ose 06-1-2695370/151 në orarin 9:00– 17:00.

Sonya[®]
Color Collection



*Presim paraqitjen e
bashkëpunonjësve tanë për
abonë 5 ose 10 ditore!*

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE KOZMETIKE

Trajtime fytyre:

- Trajtim fytyre me pastrim: 4800 Ft
- Trajtim tini me pastrim: 3500 Ft

Trajtime të vogla (pa pastrim):

- Lulja e rinisë 3000 Ft
- Luftë kundër rrudhave 2900 Ft
- Magjia e detit 2900 Ft
- Hidratim i thellë 3000 Ft
- Bombë gjallëruese 3100 Ft

Makijazh:

- Ditor: 2800 Ft
- Për rast 3500 Ft
- Dasme 4000 Ft
- Ngjijtje qerpikësh artificial:
të dredhura 150 Ft/dredhje
me radhë 2000 Ft

Ngjyrosje:

- Ngjyrosje vetullash: 500 Ft
- Ngjyrosje qerpikësh: 700 Ft
- Zbardhje mustaqesh: 500 Ft
- Zbardhje fytyre: 1000 Ft

Kolofon:

- Heqje vetullash: 500 Ft
- Kolofon mustaqesh: 500 Ft
- Kolofon fytyre: 1000 Ft
- Kolofon sqetulle: 700 Ft
- Kolofon zonash intime: 900 Ft
- Kolofon e plotë zonash intime: 1100 Ft
- Kolofon e plotë këmbë: 2500 Ft
- Kolofon këmbë deri në gju: 1700 Ft
- Kolofon krah: 1000 Ft
- Kolofon gjoksi meshkujsh: 1200/1500 Ft
- Kolofon kurrizi meshkujsh: 1500 Ft

Masazh:

- Masazh indian: 3700 Ft
- Masazh tailandez: 3800 Ft
- Masazh shpute: 3900 Ft
- Masazh relaksues aromatik/suedez: 4100 Ft
- Masazh dobësues dhe celuliti: 4600 Ft



Punonjësit e qendrës së re, masazhatorët Ildiko Hrnicsjar dhe Csilla Fülöp dhe specialistja e kozmetikës Ildiko Meszaros, u urojnë të gjithëve zbukurim, shplodhje dhe relaksim.
Ata që duan të zbukurohen dhe të mësojnë në qendrën mësimore priten vazhdimisht nga
Kata Ungar të martën dhe të enjten nga ora 10!



DR. KATALIN SURANYI
managere

***“Dëshirat nuk u lindin
askujt nëse nuk kanë
pushtetin e nevojshëm për
realizimin e tyre.”***

(Richard Bach)

LËSHOJINI

Një vit më parë nuk do e besoja se një njeri atëherë i panjohur për mua do të na ndihmojë të ndryshojmë jetën tonë.

Me sa më kujtohet gjithmonë kam patur qëllime. E dija që doja të bëhesha mjeke dhe kisha ide të qarta rreth asaj se çfarë familje dëshiroj, si do t'i edukoj fëmijët, në çfarë rrethanash dëshiroj të jetoj e të punoj — të gjitha ëndrra të realizueshme.

Gjeta një partner të shkëlqyer me të cilin deri tani kemi realizuar gjithçka që dëshironim me të vërtetë. Por vetëm ishte tepër e vështirë dhe nuk e kuptonim përse. Për shkak të frenave. Cilat janë këto frena?

Në moshën 17 vjeçare humba babanë. Në këtë kohë u përballa për herë të parë me kalimtarinë dhe me fjalinë “nuk mund t’ia lejojmë vetes”.

Frena 1.

Luftova për në universitet, dhe më morrën. Vitet universitare ishin të mrekullueshme, me shumë heqje dore dhe krenari — por arrita ta përfundoj! Isha studente e mirë, krenare për rezultatet e mia — dhe përveç familjes sime asnjëri nuk ishte kurioz për diplomën time!

Frena 2.

Fillova të punoj dhe jetoja në shtëpi me qira. Gjatë rojeve të shumta mësova si t’i shpenzoja paratë — tani isha unë që thoja: nuk mund t’ia lejoj vetes. **Frena 3.**

Punova me besim dhe entuziazëm, punova shumë dhe mendoj se mirë. Fitova aplikime, morra pjesë në konferenca, punova si përkthyes. Por kjo nuk i pëlqente të gjithëve. Mos u shfaq, por qëndro në errësirë! **Frena 4.**

Gjetëm njëri-tjetrin me bashkëshortin tim dhe u martuam. Morrën apartament nga puna — dhe ishim tepër të lumtur! Erdhën fëmijët, vepra kryesore e jetës sonë. Leje lindje, pagesë inxhinieri, kursyem. Doja të kaloja më shumë kohë me fëmijët, prandaj ika nga spitali — dhe brenda 2 muajve duhet të largoheshim nga apartamenti i punës. Kishim 90 000 forinta dhe e zgjidhëm këtë! 2,5 dhoma, parafabrikat dhe në katin e 4-t, por ishte i yni! Kredi nga OTP-ja, borxh, por s’ka problem, do të shtrëngohemi pak më shumë. **Frena 5.**

Punonim shumë, fëmijët rriteshin, ishim të lumtur, si dhe gjendja materiale u përmirësua pak. U morr vesh që djali ynë Marci ishte me astmë — dhe përsëri ëndërruam — donim të shpërnguleshim në një shtëpi private! Kursime, ndihmë

FRENAT!

nga familja, kredi më e madhe — e blemë! Ishim të lumtur, megjithëse duhet të shtrëngoheshim pak më shumë, por ndërkohë frenat takoheshin automatikisht në një gradë më të lartë.

Sëmundja e Marci-t na shqetësonte gjithmonë e më shumë. Kërkuam rrugëzgjdhje dhe rrugëzgjdhja na gjeti vetë. Në shkurt të 99-ës një kolegia ime më solli një bidon të verdhë, ndoshta na ndihmon. E nënshkrova menjëherë fletën e regjistrimit, u kapa si i mbytyri pas fijes së kashtës, pavarësisht se nuk mund t'ia lejonim vetes. I shkela pak frenat dhe i dhamë paratë për të. Marci u bë gjithmonë e më mirë, atëherë ishte e natyrshme që xheli ishte në frigorifer, dhe fëmijët ankoheshin kur mbaronte First-i. Çdo muaj merrja revistën dhe lexoja vetëm përvojat me produkte dhe artikujt mjekësor. Nuk dija asgjë se çfarë ndodhej pas bidonit të verdhë. Nuk e di se kur i arrita 2 pikët, dhe s'e kam akoma medaljen e pulëbardhës. Në vitin 2001 m'u hap një mundësi e madhe për të krijuar një klinikë mjekësore private. Për 1 vit e planifikuam, organizuam, ëndërruam — dhe e realizuam. Në korrik të 2002-shit hapla klinikën e ëndërruar të fëmijëve. Deri më sot mbushem me krenari dhe lumturi kur hyj aty. Kjo natyrisht nuk erdhi pa sakrificë:

morëm mbi shpatulla një kredi tepër të madhe.

U lodhëm. Fati ynë është fat tipik intelektual: ëndrra, qëllime, suksese, disfata, dorëheqje, djegie. Qëllimi ynë i vetëm ishte të mbijetonim nga ana materiale muajt që vinin me radhë. Mezi e duroja punën gjithmonë në rritje, ngarkesat e rënda, mungesën e perspektivës.

Në janar të 2004-ës analizova vetveten. Ku e prishëm? Nuk i përcaktuam mirë qëllimet? Nuk përdorëm mjetet e duhura? S'ka mundësi që mbusha 50 vjeç dhe jetën që më ka mbetur duhet ta kaloj duke larë kreditë dhe duke kursyer gjithmonë e më shumë! Duhet të ketë edhe një mundësi! A ka edhe një mundësi? Po i shfletoja gjithmonë e më shumë revistat Forever të grumbulluara gjatë viteve — tani me sy dhe shpirt të hapur. Për produktet e dija prej vitesh që janë të shkëlqyera — tani filloi të më interesonte edhe pjesa e biznesit. Ndërkohë linja sponsorizuese që njiha u largua prej meje. Pas telefonatave të shumta gjeta sponsorin tim aktiv, **Peter Mayer-in**.

Për çudinë time Peter-i u tregua tepër i gatshëm, erdhi nga Budapesti në Nyiregyhaza. Vetëm biseduam,

por pas kësaj pata disa netë pa gjumë. **Vendosa. Nuk dua të jetoj më me frena të shkelura!**

Me familjen ramë dakort, kërkova 6 muaj që ta provoj veten. Me Peter-in përgatitëm një plan të cilin pak a shumë e kuptova dhe e besova. Për fat të mirë shkruajtja edhe disa shifra të cilat ishin konkrete për mua — kaq prezantime, kaq të ftuar, kaq blerës shumice, kaq pikë. Më 2 prill 2004 mbajti 2 prezantime produktesh — dhe imagjinoni që biznesi funksionon kur nuk e kuptoni! Nga 20 mysafirë të asaj kohe 16 janë edhe sot blerës shumice ose bashkëpunonjës! Në mbrëmje Peter-i u kthye në shtëpi dhe unë fillova të punoj e pavarur. Vetëm, por jo e lënë pas dore. Shikoja shifrat, kontrolloja punën e bërë dhe më 20 maj arrita 25 pikë. Nuk kuptoja akoma shumë gjëra, por ndjeja diçka — ndoshta është e vërtetë?

Punoja me një ritëm të qetë, por në mënyrë të hollësishme. Që nga ai moment bëra gjithçka që më thoshte Peter-i, nuk kishte aktivitete ku nuk morra pjesë, lexoja dhe mësoja gjithmonë e më shumë, dhe pata rezultat. U bëra me bashkëpunonjës dhe blerës të kënaqur. Rendimenti i skuadrës rritej nga muaji në muaj, dhe gushtin e mbylla me mbi 30 pikë. Në këtë moment u shkelën përsëri frenat:

pa zëvendës nuk mund të shkoj me të tjerët në Greqi. Në vend që nga inati t'i bëja 75 pikët, më vinte keq për veten. Dhe këtë e arrita aq mirë, sa që më ra qarkullimi, gjë që s'kishte ndodhur më parë. Përsëri netë pa gjumë, planifikim, vendim, dhe në fund të tetorit i arrita 75 pikët!

Tani e kuptova se frenat nuk janë jashtë meje, por në mendjen dhe shpirtin tim! Nëntor 2004: 49,805 pikë; dhjetor: 40,800 pikë; janar 2005: 44,190 pikë, por unë nuk e besoja akoma se jam në gjendje ta arrij nivelin e managerit!

Në fillim të shkurtit me Peter-in planifikuam përsëri. E skicoi në mënyrë aq profesioniste zhvillimin e skuadrës, sa që u duk e besueshme që: më në fund mund të kemi rezultat. Prezantime të shumta, gjithë skuadra fillon të gumëzhijë, numërim prapa. Me Peter-in bisedonim në telefon disa herë në ditë dhe më jepte besim. Më 18 shkurt ra telefoni, i cili për pak më ra nga dora. Ishte **Miki Berkics**.

Kati, në mars duhet të mbash një leksion mjekësie në Lakitelek, por tani çfarë të shkruaj në ftesë, managere apo assistant managere?

Por Miki, më mungojnë më shumë se 38 pikë, si ta premtoj? S'ka gjë, ka edhe 10 ditë, pra të duhen vetëm 3,8 pikë në ditë.

E dini, Miki-t nuk i thua dot jo. I thashë po për leksionin dhe për nivelin e managerit gjithashtu. Që nga ai moment nuk kishte dyshim dhe nuk kishte frena, bëmë detyrën tonë dhe më 26 shkurt me 121 dhe 123 pikë u bëmë managerë.

Dhe u bë një skuadër. Herë e madhe, herë e vogël, herë lart, herë posht, por i qëndruam gjithmonë pranë njëri-tjetrit. Faleminderit që më shoqëruat dhe më ndihmuat. Tani po iu drejtohem juve. Rruga fillon vetëm tani! **Zsuzsa!** Nëse arrit ta lëshosh shkëlqimin që ndodhet brenda teje, do të jesh e aftë për mrekullira! **Kata, Attila,** u bëtë me krahë javët e kaluara, sa bukur është të futurosh, apo jo? **Ilike, Andi, Ildiko, Joli!** Jeni njerëz të shkëlqyer dhe keni një mjet të shkëlqyer në duar, nga se keni frikë? **Betti!** Jam e lumtur që të njoha, ty nuk të intereson biznesi, atëherë mos bëj gjë tjetër veçse ndihmo sa më shumë njerëz! Do ta shikoni se po të qëndrojmë bashkë, do ta provoni të gjithë shijen lumturuese të pavarësisë!

Falenderoj **Peti Mayer**-in i cili pa më njohur, në rangun e 4-t, pati aq besim tek unë sa që më dha ndihmë, njohuri dhe kohë. Atëherë më ndihmoi aq sa pata nevojë. Falenderoj **Miki Berkics**-in që më morri në telefon gjithmonë në momentin e duhur — ndoshta jo rastësisht — dhe më tha atë e cila

më nevojitej për të ecur mëtej. E di, të jesh në një biznes me Miki-n është e garantuar ndershmëria dhe bashkëpunimi me linjat vëllazërore.

Falenderoj **Jozsi Szabo**-n që e solli FLP-n në Hungari, dhe falenderoj FLP-n që djali ynë është i shëndetshëm dhe që na u dha edhe një mundësi.

Ju që mendoheni akoma dhe prisni diçka për të qenë të sigurt, më besoni se siguria ndodhet brenda nesh, në ëndrrat, qëllimet, planet dhe vendimin tonë. Nëse unë pata mundësi ta bëj përkrah mjekimit të 40-50 të sëmurëve në ditë, atëherë ju të mos keni mundësi ta bëni?

Nëse për mua është pengesë largësia nga sponsori im, atëherë ju që jetoni në një qytet, ndoshta edhe në një rrugë apo në një shtëpi, çfarë prisni? Nga Budapesti apo nga Egeri, në telefon apo personalisht morra gjithë ndihmën e nevojshme nga sponsori im. Edhe ju do ta merrni nëse e kërkon.

Vendosni, jetoni pa frena, bëhuni të pavarurur! Dhe çfarë nevojitet për këtë?

"Vendosini vetes pikësynime aq të larta, sa asnjëri nuk pret nga ju. Dhe nëse i vendosët njëherë lart, asnjëherë mos i ulni poshtë!"

(Henry Ward Beecher)

S H T Y P I

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktoi: FLP Magyarország Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Milesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Petrőczy Zsuzsanna, Pósa Kálmán, Rókás Sándor

Fotografia e kopertinës: Bakos Veronika

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzássy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. **U përgatit** në 49 250 kopje

Për përmbytjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana



Forever Nature's 18



A ia siguron organizmit pesë dozat e nevojshme të frutave dhe perimeve në ditë? Në Amerikë në bazë të udhëzimeve të shkencës së ushqimit të Departamentit Kombëtar të Kërkimit të Kancerit për çdo burrë, grua dhe fëmijë është i rëndësishëm konsumimi i pesë dozave frutash dhe perimesh në ditë. Frutat dhe perimet janë burim i rëndësishëm antioksidantësh dhe fitonutrientësh që shërbejnë funksione mbrojtëse të shëndetit dhe përfocuese të sistemit imunitar, madje edhe i shumë lëndëve ushqyese për të cilat organizmi ynë ka nevojë nga dita në ditë.

Forever Living Products dalloj se kërkesat për sigurimin e ushqimit të ekuilibruar zakonisht nuk plotësohen. Është e rëndësishme për Ju dhe gjithë familjen tuaj të sigurojmë burimet ushqimore që iu përshtaten kërkesave, prandaj krijuam produktin Forever Nature's 18. Kombinimi special i frutave dhe perimeve i siguron organizmit tonë lëndët më të rëndësishme për të cilat kemi nevojë gjatë mbështetjes së shëndetit tonë.

Katër tableta në ditë përmbajnë sasinë e antioksidantëve të pesë vafteve me fruta dhe perime. Këto i nxjerrim nga lëndët bazë të mëposhtme: rrushi, molla, boronica e zezë, shtogu i

zi, boronica e kuqe, mjedra, ekstrati i farave të rrushit. Këto fruta falë elementeve fitokimike antioksidante që përmbajnë shërbejnë mbështetjen e sistemit imunitar. *Rutina* që gjendet tek portokallja, grapefruiti, limoni dhe lime përgjigjet për ruajtjen e qarkullimit të gjakut dhe funksionit të kyçeve, kurse bananja është e njohur për përmbajtjen e lartë të *kaliumit* që ruan nivelin normal të tensionit të gjakut. Elementët fitokimik të rrepës, lakrës, lule lakrës, selinos dhe barbutjes dihet që janë të aftë të eliminojnë oksidantët që prodhohen në organizmin tonë, prandaj gjithashtu kanë efekt të madh mbrojtës shëndeti. Kivi, kumbulla, piperka pritamin, kungulli dhe majdanozi përveç përmbajtjes së lartë të vitaminës C kanë efekt të mirë edhe në tretje dhe mbrojtjen e syve.

Forever Nature's 18 është një tabletë me shije të mirë, e cila me përmbajtjen e saj të frutave dhe perimeve i siguron organizmit tonë nevojën ditore të antioksidantëve. Me tabletën Forever Nature's 18 mund të siguron sasinë ditore të frutave dhe perimeve në interes të mbrojtjes së shëndetit tuaj. Me ndihmën e këtij produkti Forever Living siguron që pavarësisht nga sfidat e përditshme, të mos hiqni dorë nga antioksidantët që merren nga konsumimi i përditshëm i frutave dhe perimeve të nevojshme.



A faded, romantic image of a man and a woman embracing. The woman is on the left, looking up at the man on the right with a joyful expression. They are both wearing light-colored, possibly white, clothing. The background is a soft, warm tone.

Senya®

Color Collection

